



USHTRIA



Viti i 71-të i botimit Nr. 23 (827568)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 11 Maj 2018

NË RAJONIN E GJIRIT TË VLORËS



Zhvillohet stërvitja "Vlora SAREX 18"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, mori pjesë më 4 maj në Stërvitjen "Vlora SAREX 18" zhvilluar nga Forca Ajrore në rajonin e Gjirit të Vlorës me pjesëmarrjen e efektivave të Forcës Ajrore, Forcës Detare, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Qendrës Kombëtare të Kërkim - Shpëtitimit,

si dhe strukturave të tjera bashkëpreuese e koordinuese në stërvitje. Në këtë stërvitje ishin të pranishëm gjithashtu zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Manushaqe Shehu, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, komandantë të forcave dhe drejtorë të drejtorive në SHP....

» faqe 5

"Jemi vend i NATO-s dhe kemi standarde shumë specifike"

Intervistë e ministres së Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka në Report TV, 3 maj 2018



» faqe 2, 4, 6, 7

60 vjetori - Akademia e Forcave të Armatosura

AFA: Institucioni unik i arsimit të lartë ushtarak

Ministrja Xhaçka: AFA do të vazhdojë të jetë prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

» faqe 3



Anëtarësimi

Projekti shqiptaro - norvegjez ALNO-HIP

Paraditen e ditës së enjte, datë 3 maj, shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut të I-rë Arsen Mullaj, zhvilloi një takim me drejtorin e projektit të përbashkët shqiptaro-norvegjez ALNO-HIP, Z. Evert Flier. Gjatë takimit u diskutua ecuria e projektit ALNO-HIP...



» faqe 5

Stërvitja "Albanian-Lion 2018"

Ushtarakë britanikë në Komandën e Forcës Detare

Të mërkurën, më 9 maj, paraditë Shefi i Shtabit i Forcës Detare, Kapiten i Rangut të I-rë Arsen Mullaj, zhvilloi një takim me ushtarakë britanikë, pjesë e grupit koordinator për stërvitjen "Albanian-Lion-2018". Qëllimi i këtij takimi ishte planëzimi dhe përcaktimi i masave paraprake dhe bashkëpunimi me Komandën e Forcës Detare për zhvillimin normal të stërvitjes "Albanian-Lion 2018", vjeshtën e këtij...

» faqe 9



NATO

A do të zbulojë Aleanca anijet përsëri?

» faqe 10

AKADEMIA E NËNOFICERËVE

25 kursantë përfundojnë Kursin e 18 të Lartë të Nënoficerit

faqe 9

NË KUADRIN E 9 MAJIT/ FITORES MBI FASHIZMIN

Shqipëria dhe kontributi i saj në fitore

Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ faqe 8

"Jemi vend i NATO-s dhe kemi standarde shumë specifike"

*Intervistë e ministres së Mbrojtjes
znj.Olta Xhaçka në Report TV, 3 maj 2018*

Doja ta nisja me propozimet që ju i keni bërë sekretarit Mattis, cila kanë qenë këto propozime?

Në fakt doja ta nisja me një parathënie për të thënë se Shqipëria, si një vend anëtar i NATO, është një aleat shumë i besueshëm për Aleancën, por edhe për partnerin e saj strategjik SHBA, është një partner i besueshëm edhe për shkak të gatishmërisë së saj edhe rritjes së operacionalitetit të Forcës së Armatosur, por edhe të gjithë angazhimeve në operacione dhe misione të Aleancës apo edhe të BE; është një aleat i besueshëm sepse luan një rol të rëndësishëm stabiliteti, luan rol të rëndësishëm në stabilitetin në rajon, promotor i politikës së dyerve të hapura të NATO edhe asistencës ndaj të gjitha vendeve, të cilat në Ballkanin Perëndimor aspirojnë që të bëhen pjesë e Familjes Euroatlantike dhe për ne ky destinacion është shumë i rëndësishëm dhe kemi qenë promotor vërtetë të fuqishëm të kësaj politike dhe të kësaj filozofie. Për këtë arsye duke qenë se Shqipëria në vitet e fundit ka treguar përmes angazhimit të saj operacional, përmes operacioneve dhe misioneve, përmes të qenurit në krahun e duhur, të qenurit pjesë e Aleancës, por edhe përmes angazhimeve të saj për modernizimin e ushtrisë, për rritjen e buxhetit të Mbrojtjes deri në masën 2% deri në vitin 2024, ashtu si kanë qenë në fakt edhe angazhimet e kryeministrit, por edhe të vendeve të tjera në samitin e Uellsit por edhe një kërkesë e vazhdueshme edhe e partnerëve

Aktualisht sa është ky buxhet?

Aktualisht buxheti është 1,2% dhe kemi pasur një trend rritës i cili do të vazhdojë të jetë i tillë deri në vitin 2024. Për të gjitha këto arsye Shqipëria është sot, do të thosha Aleati më i besueshëm në rajon. Dhe duke qenë që NATO nuk ka zhvilluar kapacitete të saja në Ballkanin Perëndimor, pra në rajonin tonë, duke qenë që situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor ka ndryshuar dhe në këndvështrimin tim nevojitet një vëmendje më e madhe e NATO apo e SHBA, propozimi im ka qenë se qoftë në formatin bilateral në SHBA qoftë në formatin NATO, nëse do të kishte zhvillim të kapaciteteve të tyre në rajon, Shqipëria do të ishte natyrshëm një vend kontakti, një aleat i denjë për të pasur një footprint, apo një, unë e kam dëgjuar në media shpesh, një bazë ushtarake. Jo domosdoshmërisht një bazë ushtarake, mund të jetë një bazë ushtarake, mund të jetë një qendër stërvitore, por do të ishte gjithsesi një gjurmë e Aleancës apo e SHBA partnerit tonë strategjik, në Shqipëri, e cila do të ishte përfaqësuese për të gjithë rajonin.

Po a kemi infrastrukturën e duhur, i referohem bazave tokësore, ujore. Mesa di unë pjesa ajrore kontrollon edhe sot e kësaj dite nga vende të NATO, si Italia?

Shiko mundësi ka shumë. Ne ju kemi vënë në dispozicion kapacitetet tona tokësore, ajrore edhe detare. Mundësi ka për të zhvilluar kapacitete në furnizimin me karburant, mundësi ka për të zhvilluar bazat tona detare, mundësi ka për të zhvilluar qendrat tona stërvitore në funksion të stërvitjeve të Aleancës, apo të SHBA, mundësit janë të shumta. Ajo që kam bërë ishte një propozim për



të konsideruar këto mundësi.

Cila ishte përgjigja e sekretarit të Mbrojtjes?

Ai tregoi vërtet mbështetjen e tij për një vend si Shqipëria, do të thosha edhe mirënjohjen e tij për një vend si Shqipëria, që pavarësisht përmasave gjeografike apo mundësive apo pamundësive të saj ka qenë kontribues vërtet shumë i madh për Aleancën. Vlen të thuhet që angazhimet tona operacionale, misioneve në operacione krahasuar me popullsinë tonë apo me numrin e FA, mbeten ndër më të lartat në Aleancë. Sigurisht ky ka qenë një nga ato element që edhe sekretari Mattis, por edhe drejtues të tjerë të Aleancës e kanë evidentuar në mënyrë të vazhdueshme dhe e kanë përgëzuar gjithmonë me shumë mirënjohje.

A ka plan të afërt SHBA, ose NATO për të vendosur një bazë në Shqipëri?

Jo, nuk ka asnjë plan të afërt, as të SHBA as të NATO për të vendosur një bazë në Shqipëri. Ishte vetëm një temë e diskutimit që kemi zhvilluar, ishte një propozim i bërë nga ana ime, qoftë për të treguar rëndësinë e zgjerimit të bashkëpunimit tonë strategjik, të partneritetit tonë strategjik, por edhe për të vënë në dispozicion të Aleancës por edhe të SHBA, kapacitet tona, tokësore, detare dhe ajrore. Kjo nuk do të thotë që ka një plan të afërt, absolutisht jo, por një bazë e NATO apo e SHBA do të ishte absolutisht shumë e favorshme për Shqipërinë. Jo vetëm do të çimentonte këtë partneritet strategjik me SHBA dhe Aleancën, por dot tregonte që Shqipëria është një aleat i besueshëm dhe pikë kontakti për Aleancën në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe njëkohësisht do të sillte investim në atë zonë ku do të bëhej.

Pra do të kishim edhe përfitime ekonomike do të thoni ju...

Pa diskutim, në atë vend ku do të zhvillohej ai projekt.

Në fakt dua t'ju pyes sepse janë bërë pak të shpeshta vizitat e ministrave tanë të Mbrojtjes, para jush ka qenë zonja Kodheli në SHBA. Cili ishte qëllimi i kësaj vizite, pati ndonjë shqetësim nga Pentagoni në raport edhe me sigurinë në rajon, apo ishte një vizitë normale bilaterale?

Nuk është një vizitë normale bilaterale, të tilla vizita nuk janë të shpeshta për Pentagonin...

Prandaj ju pyeta se brenda dy vitesh kanë qenë dy ministra të Mbrojtjes?

Gjatë kësaj vizite është zhvilluar edhe një negociatë bilaterale për të eksploruar të gjitha mundësitë për zgjerimin e bashkëpunimit tonë dhe për suportin që SHBA-të i kanë dhënë vazhdimisht FA, për trajnimin, edukimin dhe modernizimin. Zhvillimi i këtyre negociatave, zhvillimi i këtyre bisedimeve është në kuadër të kësaj mbështetjeje që Amerika na i ka dhënë vazhdimisht dhe vazhdon të na e japë në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithmonë në rritje.

Kur flasim për bashkëpunim padyshim që pyetja lind natyrshëm, a ka plane qeveria shqiptare të blejë armatim nga SHBA?

Nuk është çështje planesh. Modernizimi i FA-ve është një sfidë e përditshme. SHBA sapo na kanë dhuruar shumë mjete të blinduara të cilat janë realisht një ndihmë e jashtëzakonshme për mbërritjen e objektivave të kapacitetit, angazhimeve që ne u kemi deklaruar edhe Aleancës, për të bërë FA dhe më saktë gjithë komponentin e këmbësorisë shumë më të ndërveprueshëm me forcat e Aleancës dhe sigurisht shumë më të mirëpajisur edhe më të modernizuar për t'u përballur me sfidat në misione dhe operacione të Aleancës. Kjo ka qenë një ndihmë e jashtëzakonshme. SHBA na kanë dhënë një ndihmë të vazhdueshme në trajnimin dhe edukimin e efektivëve tanë, pasi i gjithë modernizimi apo të gjitha këto mundësi do të ishin të kota

nëse ne nuk do të investonim te kapitali njerëzor.

Kemi një shifër sot, sa është numri i këtyre mjeteve (ne i kemi parë edhe në rrugë), kemi një numër të saktë sa do të jetë numri i mjeteve ushtarake që do t'i jepen Shqipërisë dhuratë?

Do të jenë shumë, por sigurisht do të dislokohen në disa momente, por janë disa qindra.

Përsa i përket armatimeve të tjera, parashikohen edhe përsa i përket Forcës Detare dhe Ajrore?

Modernizimi është një proces i vazhdueshëm, është sfidë, sepse është një procesi i lidhur ngushtësisht edhe me buxhetin në dispozicion të Mbrojtjes dhe sigurisht për një vend që nevojat i ka emergjente i ka emergjente për infrastrukturë, për shkollë, për spitale, për rrugë, për shërbime shumë më cilësore, për ndihme ekonomike, për aftësi të kufizuar, etj., është e vështirë që të bësh, le të themi një argument shumë të fortë, për të rritur buxhetin e Mbrojtjes, në kushtet kur nuk ka një armik pas dere apo një rrezik eminent që i paraqitet vendit. Megjithatë, pavarësisht se nuk ka një të tillë, Aleanca, si e tërë, sot përballet me shumë sfida që janë ndryshe nga ato që ishin dje, që janë asimetrike, që janë hibride dhe që janë të një natyre që pa diskutim duan adresuar bashkërisht në një mënyrë kolektive ashtu si po bëjmë. Në këto kushte modernizimi i ushtrisë është sfidë, por njëkohësisht edhe domosdoshmëri. Po tentojmë që të gjejmë një ekuilibër shumë të mirë edhe me angazhimin e kryeministrit edhe me angazhimin e ministrit të Financave por fatmirësisht edhe për shkak të mirëmenaxhimit të financave publike kemi arritur që të paktën këto dy vitet e fundit, buxheti për Mbrojtjen të ketë parë rritjen e parashikuar, për të mbërritur në ato parametra që deri në 2024 përqindja e Prodhimit të Brendshëm Bruto për buxhetin e Mbrojtjes të jetë 2%. Sigurisht 2% do të zgjidhë shumë nga problematikat që kemi. Megjithatë,

siç ua thashë, modernizimi është një sfidë e përditshme. Sot jeni kushtet ku mund të themi se jeni në kushtet ku kemi zëvendësuar, ose jemi duke zëvendësuar të gjithë armatimin e vjetër kinez apo rus dhe po pajisemi me armatimin më modern me standardet të NATO. Jemi duke pajisur FA me mjete të blinduara të standardit tonë më të mirë, Policinë Ushtarake me mjete të blinduara të standardit më të mirë, automatikë, murtaja, pajimet e ushtarëve, të cila janë shumë të domosdoshme për të qenë të ndërveprueshëm bashkë me aleatë tanë në një teatër lufte apo në një operacion të përbashkët janë pa diskutim arritje të përditshme të FA tona, por edhe sfida për të ardhmen.

Megjithatë, jemi ne, në kushte për të blerë edhe avion luftarakë apo është shpejt për të folur për këtë?

Jo, është shpejt për të folur për këtë. Ne kemi një Forcë Ajrore, që është e orientuar drejt helikopterëve dhe nevojat tona janë të tilla.

Pse, nuk është pjesë e strategjive, ashtu si kemi pasur kur ishim një vend i izoluar kishim, një flotë ajrore, sot është e panevojshme kjo, duke parë që të gjitha vendet fqinje janë të armatosura në këtë drejtim?

Ka një logjikë edhe zhvillimi edhe modernizimi i FA. Do të ishte shumë mirë të kishim më shumë anije, më shumë avionë, të kishim më shumë automatikë të një kalibri të caktuar.

Por një flotë modeste nuk do ishim keq ta kishim...

Mundësitë modeste që kemi na detyrojnë të shtrimë këmbët aq sa kemi jorganin. Edhe ka edhe një logjikë për mënyrën se si profilizohet një ushtri e një vendi si i joni që është vend anëtar i NATO. Në bashkëpunim me aleatet tanë kemi deklaruar disa që quhen objektiva kapaciteti, kush janë objektivat tanë afatshkurtër, afatmesëm edhe afatgjatë për të modernizuar FA tonë dhe për ta bërë atë të ndërveprueshme dhe ky është një proces që hap pas hapi rakordohet me partnerët tanë. Ata, bashkë me ne, identifikojmë se kush janë nevojat tona më imediate dhe pastaj investojmë bashkërisht për të mbërritur këto objektiva në funksion të qëllimeve të përbashkëta të Mbrojtjes Kolektive

Zonja Ministre për t'ju kthyer edhe njëherë vizitës edhe takimit me Mattis, a ka shqetësim amerikan në raport me çfarë po ndodh në rajon, për ndikim rus apo të aktorëve të tjerë dhe a u shfaq ky shqetësim në takimin që ju kishit?

Pa diskutim që ka shqetësim amerikan dhe shqetësim të Aleancës. Sot aleanca, ua thashë, përballet me një ambient sigurie krejt ndryshe nga ai

(vijon në fq. 4)

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Albert **ZHOLI**

Gazetarë:
Saimir **ALIJA**
Iilir **LAME**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**
Redaktore/Korrektore:
Anila **DODA**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

60 vjetori AFA

AFA: Institucioni unik i
arsimit të lartë ushtarak

Ministrja Xhaçka: Akademia e Forcave të Armatosura do të vazhdojë të jetë prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura



një vizion të ri që reflekton elementët cilësorë të filozofisë së re të arsimit ushtarak bashkëkohor, që duke i paraprirë zhvillimit dhe transformimit të mëtejshëm të Forcave të Armatosura.

Komandanti/Rektori i AFA Kolonel Dr. Eduard Bala, në fjalën e tij theksoi se... "thelbesore në misionin e Akademisë së FA në këto 6 dekada është përgatitja e lartë profesionale dhe në nivele të ndryshme të lidershipit drejtues të Forcave të Armatosura ndër vite, në përputhje me misionin e FA të RSH, në shërbim të kombit dhe atdheut. Kjo ka bërë, që Akademia të vazhdojë me shumë sukses detyrën e saj edhe në sfidat e reja me të cilat janë duke u përballur FA, duke vijuar edukimin profesional të lidershipit ushtarak për tu ballafaquar dhe realizuar me sukses misionin mbi këto sfida. Ky përvjetor historik më krijon besimin e

patundur që edhe në të ardhmen Akademia e Forcave të Armatosura do të qëndroj në ballë të misionit, rolit dhe detyrave për të përgatitur një lidership drejtues ushtarak i cili do të jetë e aftë të realizoj me sukses në misionin që FA kanë në kuadër të mbrojtjes së vendit, përballjes me fatkeqësitë natyrore dhe në ndihmë të popullit tonë por edhe të bashkëpunimit të sukseshëm në kuadër të Aleancës me NATO-n."

Në fjalën përshëndetëse Komandanti i KDS Gjeneral Brigadë Prof. Asoc. Bajram Begaj vuri në dukje se... "Akademia e Forcave të Armatosura, përfaqëson institucionin më të lartë të arsimit ushtarak në vendin tonë, institucion me profil të veçantë, i cili për një periudhë 60 vjeçare ka luajtur dhe luan një rol parësor në përgatitjen dhe kualifikimin e ushtarakëve dhe civilëve të të gjitha niveleve

të komandimit e të drejtimit në strukturat e Forcave tona të Armatosura. ... Në këtë ditë të shënuar përulmi me nderim të thellë para të gjithë atyre studentëve, pedagogëve, dhe dashamirësve të tjerë të arsimit ushtarak që themeluan 60 vjet më parë këtë akademi, si promotor kryesor i mendimit ushtarak dhe punës shkencore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, traditës së pasur të Forcave të Armatosura e historisë ushtarake". Më tej Gjeneral Bega vuri në dukje programet e kurseve që zhvillohen në Akademi si pjesë e sistemit të arsimit të lartë ushtarak programet e Kursit të Lartë të Sigurisë e Mbrojtjes, Kursit të Lartë të Oficerit, Kursit të Komandës të Shtabit të Përgjithshëm, Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit, Kursi i Arsimit të Përgjithshëm të Oficerit, kurset në gjuhët angleze, frënge, gjer-

mane, italiane, turke, greke, serbe si dhe programe të kurseve për kontingjentet e trupave tona që nisen për misione në kuadër të Aleancës. Komandanti i KDS vuri në dukje se... "Arsimimi duhet të zhvillohet në një mënyrë të tillë që t'i paraprijë transformimit të Forcave të Armatosura, duke përditësuar metodologjinë, programet mësimore e doktrinën ushtarake, hartuar dhe rishikuar procedurat standarde, për të normëzuar e unifikuar proceset dhe për të siguruar ndërveprueshmërinë me aleatët, me qëllim që t'u përgjigjet nevojave kombëtare, realitetëve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë dhe të jetë i përputhshëm me sistemin e arsimit kombëtar dhe shkollave të vendeve të NATO-s.

Gjithashtu Komandanti i KDS shprehu mirënjohjen për Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Universitet e institucionet brenda dhe jashtë vendit për mbështetjen e dhënë duke kontribuar në arritjet, pozicionin dhe reputacionin e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe në tërësi të arsimit ushtarak, ku padyshim mirënjohje dhe falënderim shkon në kuadër të bashkëpunimit të përbashkët mbi trajnimin dhe arsimimin ushtarak me vendet e rajonit si SHBA, Britani, Gjermani, Turqi, Itali, Greqi, etj. Duke veçuar qendrën Marshall, Kolegjin e Romës, Qendrën e Studimeve Studimeve të Larta të Mbrojtjes, Akademisë e Drejtimit të Hamburgut, si dhe akademitë e kolegjet e vendeve anëtare të NATO-s, etj.

Në përfundim Komandanti i KDS Gjeneral Brigadë Bajram Bega theksoi se: "Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes do të jetë në mbështetje të përmbushjes së sfidave të arsimit ushtarak profesional jo vetëm për vitin që jemi, por edhe në vitet në vijim, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit i Agjencisë së Sigurimit në Arsimin e Lartë; për përmirësimin e programeve dhe modernizimin e metodologjisë dhe për të aplikuar mësimet e nxjerra për të rritur nivelin e formimit të lidershipit të ardhshëm të FA, në të gjitha nivelet e kurseve institucionale, duke e çuar në një format strukturimi si institucioni i vetëm ekspert në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, konform standardeve të arsimit të lartë kombëtar, me fakultete, programe studimi të akredituara, të ciklit të dytë "Master Profesional" e "Master i Shkencave", si dhe aplikim të programit të doktoraturës, në studime për fushën e mbrojtjes e sigurisë".

Në emër të ish komandantëve që e kanë drejtuar Akademinë vite foli Gjeneral Brigadë në pension Prof. Dr. Kostaq Karoli.

Në fjalën e Tij, Profesor Karoli vuri në dukje se Akademia u krijua më 10 maj 1958, si rezultat një pune të palodhur të Komandantit të parë të Akademisë Kolonel Thoma Xhixho si dhe stafit të Akademisë në ato vite. Gjithashtu Profesor Karoli falënderoi gjithë Komandantët e Akademisë profesorët dhe pedagogët që kanë punuar për 6 dekada rresht me profesionalizëm dhe përkushtim në përmbushje të misionit të Akademisë.

XHAÇKA NË BURREL:

Të komunikojmë me gjithsecilin për gjithçka sa kemi bërë

Bashkia Burrel ka qenë ndalesa e radhës e ministres së Mbrojtjes Olta Xhaçka gjatë turit të llogaridhënies publike të qeverisë. Në takim me banorë të Njësisë Administrative të Ulzës, ministrja Xhaçka tha se nuk ka imunitet politik kur bëhet fjalë për cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. "Pritshmëritë për ne janë vërtetë shumë të larta, sepse njerëzit që na kanë votuar dhe besuar që të qeverisim vetëm, na kanë dhënë përgjegjësinë për të bërë të vërtetë të gjithë ato premtime, apo atë vizion qeverisës që ne kemi ndarë me ta, por nga ana tjetër edhe përgjegjësia është e gjitha e jona, nuk kemi me kë e ndajmë, për ato gjëra që nuk i bëjmë ashtu si duhet, apo që nuk arrijmë t'i bëjmë dot. Kjo është arsyeja se përse këtë gjashtëmuor, përveçse e kemi bërë analizë si ministra me kryeministrin, apo si anëtarë të një qeverie të PS me grupin tonë parlamentar, kemi ven-



dosur që ta zbrisim në terren, atje ku është forca jonë edhe atje ku është thelbi i punës që bëjmë, tek njerëzit, për të komunikuar me gjithsecilin për gjithçka sa kemi bërë", - deklaroi ajo. Duke u ndaluar në projektet e qeverisë për më shumë investime në këtë zonë, ministrja tha që puna e mirë e bërë deri tani do të vijojë më tej, kryesisht në promovimin e vlerave turistike të zonës. "Ulza është një vend shumë i bukur, ka një ambicie vërtetë shumë të sinqertë të shumë aktorëve, përfshi edhe kryeministrin për më shumë projekte, për më

shumë investime për ta bërë më atraktive për turizmin. Është një projekt shumë i bukur për të bërë shëtitoren e liqenit, për ta bërë liqenin një vend vërtetë turistik, të lundrueshëm, me shumë aspekte për një turizëm më atraktiv për zonën".

Në bashkëbisedimin me banorët e Njësisë Administrative Baz, ministrja Xhaçka i inkurajoi që të gjitha shqetësimet e tyre t'i shprehin nëpërmjet portalit për bashkëqeverisjen. "Shumë prej jush, jo vetëm këtu, por në të gjithë Shqipërinë keni hasur probleme në zyrat ku kërkonit të merrni shërbime, sepse nuk gjeni dot zgjidhje atje. Ne e kemi zgjidhur me portalin e bashkëqeverisjes, ku çdo drejtori, çdo ministri deri edhe kryeministri njihet me problemet e gjithsecilit dhe u jep zgjidhje brenda 10 ditëve. Çdo ankesë që futet në portal dhe për këtë ju mund të keni ndihmën e zyrave tona që janë ngritur në Burrel, ndaj është shumë e rëndësishme që të kërkonit të drejtën tuaj për një shërbim më të mirë, përmes këtij portalit", - deklaroi ministrja Xhaçka.

"As SHBA as NATO nuk kanë plan për të vendosur një bazë në Shqipëri"

(vijon nga fq. 2)

ç'ka qenë dje, influenza, është zhargon i zakonshëm i Aleancës, influenza që vjen nga Lindja, apo nga Jugu. Vura re që në media retorika ime ose e Aleancës, kërcënime që vijnë nga jugu, u keqinterpretuan. Dikush shkruante e ka fjalën për Greqinë. Nuk bëhet fjalë për Greqinë. Bëhet fjalë për Rusinë, që është Lindja e Aleancës dhe bëhet fjalë për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut që është Jugu i Aleancës. Dhe të dyja këto pole, le të themi, janë shumë të rëndësishme për çfarë po ndodh sot dhe vëmendja kryesore është tek ato. Sigurisht unë bëra një argument, të cilin, nuk jam e vetme në këtë logjikë, që edhe Ballkani Perëndimor sot ka nevojë për një vëmendje më të madhe të Aleancës për shkak të kërcënimeve asimetrike dhe hibride që vijnë qoftë nga Lindja pra po themi nga Rusia, qoftë përmes një influence më të madhe të saj; qoftë nga Jugu që janë terrorizmi, imigracioni i paligjshëm, që mund të prekë edhe çështjet tona.

Në këtë kontekst ishte edhe propozimi juaj për një bazë të NATO, apo ishte thjesht një dëshirë? Në fakt çdo ministër i Mbrojtjes e ka patur këtë dëshirë. Ishte thjesht dëshirë apo ju dhe qeveria ka parasysh një risk dhe kërkon një lloj proteksioni qoftë edhe nëpërmjet një baze?

Nuk ka absolutisht asnjë lloj risku dhe proteksioni nuk vjen përmes bazës. Ne jemi shumë të mbrojtur sepse jemi një vend aleat i NATO dhe në qoftë se ke cenuar një vend aleat të NATO, ke cenuar gjithë Aleancën. Këtu nuk diskutohet për kërcënim nominal, këtu diskutohet për një situatë sigurie dhe për një rajon i cili destinacionin, në mënyrë absolute, duhet dhe do ta ketë tek Familja Euroatlantike. Nëse aktorë të tjerë e pengojnë këtë destinacion të disa vendeve, ne si faktor stabiliteti, bashkë me partnerët tanë strategjikë, synojmë që këtë proces ta nxisim dhe ta përsheptomë drejt këtij destinacioni të natyrshëm.

Ju pak ditë më parë, mos gaboj, keni patur edhe një ceremoni në raport me rekrutimin e disa, le të themi, individëve që t'i bashkohen FA. Zonja Xhaçka, a ka dëshirë për të qenë pjesë e ushtrisë? Dikur ka patur një lloj shkëputje, një lloj mungese vullnetarizmi në raport me këtë, po e quaj profesion, po është degë shumë e rëndësishme e vendit. Si ka ndryshuar kjo? Çfarë kushtesh ofron ushtria për një të ri që dëshiron ose e ka ambicie për të qenë pjesë e ushtrisë?

Unë të falënderoj shumë që ma bën këtë pyetje sepse besoj që është një pyetje jashtëzakonisht e rëndësishme edhe është një shqetësim shumë i posaçëm që kam. Dhe do të tregohem shumë e sinqertë për të thënë që edhe ka, edhe nuk ka interes. Sot, trajtimi i ushtarakëve tanë, nuk është ai që duhet të ishte, nuk është ai që ne do donim që të ishte për ta. Megjithatë, një karrierë në ushtri dhe një profesion si ushtarak, pavarësisht se paraqitet me shumë sakrificë dhe kufizime, është një ndër profesionet më të nderuar, që do të veshë me krenari këdo që e ushtron, por edhe femijet e tij, duke qenë se i shërben me devotshmëri dhe më me patriotizëm se kushdo tjetër atdheut të vet. Është një profesion, i cili të ofron shumë mundësi. Ndoshta është e vështirë për një të ri, i cili nuk e njeh ushtrinë sepse përgjithësisht është një nga ato institucione puna e të cilit nuk duket, pra nuk është fort vizibël, edhe ndoshta është e vështirë edhe të tregosh realisht se si është puna e një ushtaraku dhe kush janë kushtet e tij për të përparuar në karrierë. Por, po të shohim edhe vende të tjera, vende aleate, se si përparon një ushtarak në karrierë, për të qenë edhe në rangjet më të larta dhe çfarë përfitimesh ka nga sistemi arsimor apo nga trajnimet e jashtëzakonshme që nuk merren vetëm në vendin tonë, por në vendet tona aleate. Mundësi për shkol-

lim, bursave dhe masterave në qendrat më të rëndësishme ushtarake në botë, në shkollat më prestigjioze ushtarake në botë, me mundësi të jashtëzakonshme për të përparuar jo vetëm si njeri, si intelekt, por edhe si një profesionist vërtet shumë i mirë, janë të panumërta për dikë që ka vullnetin edhe dëshirën për të përparuar në karrierën e vet si ushtarak.

Atëherë çfarë e pengon një të ri, i cili është dhe pa punë, rri kafeneve e vërtitet, çfarë e pengon t'i bashkohet ushtrisë?

Ndoshta një njohje më e mirë e saj dhe për këtë, kemi edhe ne shumë për të bërë, për të promovuar ushtrinë ashtu siç duhet edhe për të promovuar tek këta të rinj mundësitë e jashtëzakonshme që ushtria dhe FA ofron. Njëkohësisht kemi shumë për të bërë për t'u ofruar ushtarakëve tanë një trajtim më të mirë, që do të thotë edhe një pagë më të mirë dhe jam shumë e kënaqur që, kryeministri vetë, u premtoi të gjithë efektivëve të FA që ky do të ishte viti i fundit, që do të

të jetës, në dobi të atdheut. Dhe në këtë kuptim besoj që ka sot një detyrim edhe të shoqërisë por edhe të qeverisë për këta njerëz.

Për këta ushtarakë dhe punonjës që shërbejnë në FA që na ndjekin në këto moment zonja Ministre, pse kjo diferencë vlerësimi në raport me Policinë? Dhe ju thatë që ka një angazhim qeveritar, do të fillojë të ndjehet ky këtë vit, në raport edhe me pagat e tyre?

Do të fillojë të ndihet në vitin tjetër. Të paktën ky është parashikimi që kemi për momentin. Nuk di t'ju them arsyet pse, por di t'ju them se ka shumë vite që...

Kjo nuk i përket vetëm kësaj qeverie, ka 20 e ca vite që Ushtria qëndron në harresë. A ka ndryshim në konceptin e vlerës së Ushtrisë?

Po. E keni dëgjuar edhe nga goja e kryeministrit. E dëgjoni në mënyrë



kishte një diferencë aq të madhe të pagës mes ushtarakëve dhe forcave të policisë. Dhe ky pa diskutim është një angazhim shumë i rëndësishëm për të treguar respekt ndaj një profesioni të vështirë, por ndaj disa njerëzve që e bëjnë punën e tyre me shumë ndershmëri, me shumë devocion dhe me shumë krenari për të gjithë ne. I keni parë, kam përshlytjen, vërtet është një profesion që nuk duket, por përmes ndihmës që i kanë dhënë komunitetit gjatë kësaj periudhe shumë më e dukshme dhe shumë më e posaçme, me kontributin e jashtëzakonshëm dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm gjatë emergjencave civile por edhe në kohë, le të themi më pak të vrullshme, me ndihmësën e tyre në komunitete të ndryshme, qoftë me ndërtime e urave, qoftë me zgjerimin e rrugëve në fshatrat më të izoluar, qoftë me ofrimin e ndihmës për shërbime shëndetësore përmes mjekëve tanë ushtarakë ju kemi ndenjur shumë më pranë njerëzve dhe besoj që ka filluar të jetë pak më e dukshme puna e jashtëzakonshme, përkushtimi, sakrificë në dobi të të mirës së përbashkët, në dobi të siguri

të tërthortë edhe nga ministri i Financave, i cili dedikon buxhet të posaçëm Mbrojtjes edhe në sajë të angazhimit për të pasur një rritje të buxhetit përkundrejt premtimit dhe angazhimit që kemi tek aleatët tanë. E dëgjoni nga ministri i Mbrojtjes në mënyrë të vazhdueshme edhe besoj që është një nevojë e dukshme që shumë shpejt gjithë bashkarish do t'i përgjigjemi.

Sa është numri i Forcave tona të Armatosura sot?

Është plus 8 mijë.

8 mijë efektivë. Po Forca Komando? Ato që cilësohen si forcat elitë, sa është numri i tyre aktualisht zonja Xhaçka dhe çfarë komunikimi keni me ta?

Po çfarë lidhje ka kjo?

Jo, në sensin çfarë komunikimi ka, sepse ka një shqetësim sidomos nga ata që mbarojnë misionet, mbeten edhe pa punë...

Kjo nuk është e vërtetë.

Nuk është e vërtetë që ata kur kthehen nga misionet e tyre nuk kanë punë?

Jo. Ka një ligj që orienton FA. Për ata që nuk përparojnë dot në gradë, mbas x vitesh kontribut, duhet të dalin nga skema. Në qoftë se dikush është i Forcave Komando dhe nuk përparon dot në gradë se nuk ka kapur parametrat, unë e shoh të vështirë.

Pavarësisht se ka shërbyer në Irak e Afganistan për shembull?

Pavarësisht. Ka dashur të dalë ose nuk ia ka dalë të përparojë një gradë më tutje. Por FA është përparim në karrierë edhe rregullohet nga një ligj i posaçëm, i cili nuk të lejon ta shkelësh kur dikush nuk përparon. Ose kap moshën ose nuk kap gradën.

Një lajm i pak ditëve më parë kishte të bënte edhe me kolonel Demiraj, Dritan Demirajn, i cili ka shërbyer, për ata që e njohin, edhe si ministër i Brendshëm për një periudhë të shkurtër, ministër teknik i PD. A është rikthyer me një firmë tuajën në FA? Çfarë ka ndodhur realisht? Ju keni reflektuar Vendimin e Gjykatës, apo ka pasur një, le të themi, një hapje e dyerve që ju i keni bërë rikthimit të tij në forcat e ushtrisë?

Atëherë, ka një rregull shumë të fortë në FA, që është zbatimi i ligjit. Ka një Vendim Gjykatë të formës së prerë

Ka shumë vendime gjykatë që nuk zbatohen me rikthim në detyrë.

Jo jo zbatohen. Në FA je i detyruar që t'i zbatosh.

Nuk ka përjashtime.

Absolutisht jo. Nuk njoh unë një sot, që të ketë vendim gjykatë dhe, të mos jetë kthyer.

Në Ministri të tjera ka. Ushtria mbase ka një rregull tjetër.

Nuk besoj ta keni dëgjuar ndonjëherë këtë konfliktin politik në FA. Rregulli është shumë i qartë. Në zbatojmë ligjin në mënyrë rigorozë. Përsa kohë ka një vendim gjykatë të formës së prerë, kolonel Demiraj duhet të kthehet në FA. Dhe në momentin që dikush është pjesëtar i Forcave tona të Armatosura edhe bën betimin për t'i shërbyer atdheut, është zhveshur nga uniforma e politikës dhe ka veshur ngjyrat e flamurit. Kështu që në këtë pikë, nuk ka absolutisht asnjë ekuivok, Ushtria është e përbërë nga njerëz, bindjet e të cilëve unë nuk i njoh edhe nuk dua t'i njoh. Jemi atje për një mision shumë më të lartë.

Zoti Demiraj e ka një problem qoftë edhe moral, sepse ka qenë

përfaqësuesi i një partie politike në qeveri. Nuk përbën problem për FA ky fakt?

Nuk përbën asnjë problem për sa kohë që nuk ka qenë efektiv aktiv i FA. Në momentin që është efektiv i FA, ligji nuk ia njeh më të drejtën për të qenë qoftë i përfshirë politikisht, qoftë për të pasur një opinion të shprehur politik. Kështu që në këtë pikë jua thash, ushtarakët tanë janë të zhveshur nga ngjyrat politike edhe janë shërbëtorë të atdheut.

Çfarë bën apo jeni akoma në procedura?

Jemi në procedura.

Ai ju ka bërë një falënderim publik në fakt. Nuk e di nëse keni komunikuar me të.

Jo, nuk ka komunikuar me të.

Po çfarë mund të bëjë ai për shembull, nuk e di, do rikthehet sërish në misione ndërkombëtare apo mbetet për tu diskutuar pozicionin i tij në ushtri? Apo është pjesë e shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

Pozicioni i tij në ushtri, është pjesë e Shtabit të Përgjithshëm, është edhe pjesë e ministrit. Por sigurisht që propozimi vjen nga Shtabi i Përgjithshëm, miratimi vjen nga ministri në rastin e kolonelëve. Dhe do të bëjë një detyrë që është e përshtatshme për gradën e tij.

E qartë. Mirë, do doja t'ju pyesja pak edhe për një shqetësim qoftë edhe publik, qoftë edhe qytetar. Ka edhe disa njerëz, qytetarë që nuk janë dakord me përfshirjen e Ushtrisë në pastrimin e territorit, apo atë, le ta themi më shqip, heqjen e mbeturinave, plehrave në pjesë të ndryshme të Shqipërisë. Pse edhe ju si ish - ministria Kodheli e keni vazhduar këtë traditë për ta përdorur Ushtrinë në këto lloj operacionesh? Është pak ulje e dinjitetit të tyre apo si e gjykoni ju?

Në fakt terminologjia është e gabuar. Nuk është përdorje e ushtrisë. Kemi të bëjmë, mund edhe ta quash një emergjencë civile, mund edhe ta quash një emergjencë kombëtare faktin që Shqipëria sot është e zhytur në plehra. Dhe ky nuk është një aksion i ushtrisë, është një aksion vullnetar i të gjithëve: edhe i efektivëve tanë, edhe i mësuesve tanë, edhe i nxënësve tanë, edhe i Administratës, edhe i punonjësve të Bashkisë, edhe i intelektualëve, edhe i qytetarëve të atyre komuniteteve. Është një aksion vullnetar i të gjithëve. Dhe në këto kushte, pa diskutim që edhe ne do t'i përgjigjemi me shumë pozitivitet dhe me kapacitetet tona një emergjencë civile, kombëtare, e cila pa diskutim është shumë e rëndësishme për t'u adresuar në të mirë të përgjithshme të gjithë secilit prej nesh.

Megjithatë ne kemi edhe aprovimin e FA, e kolonelëve, e gjeneralëve? Se ju jeni pjesa politike. Ju ndoshta mund ta kërkonti këtë, po në fund të fundit duhet të vendosë pjesa ushtarake për këtë. Keni një aprovim, apo keni një mirëkuptim për këtë?

Po ju si mendoni se lëvizin efektivët tanë ushtarakë në qoftë se komanda e tyre e menaxhimit...

Mund t'ju jap një informacion zonja Xhaçka, që ka patur fërkime, përplasje, mes ish - ministres dhe pjesës ushtarake. Ndoshta me ju ka ndryshuar kjo, por, mes tyre ka patur.

(vijon në fq. 6)

DITA E DËSHMORËVE

5 maj-homazhe në "Varrezat e Dëshmorëve"

Më 5 maj, paradite në "Varrezat e Dëshmorëve" janë përkujtuar me nderim dhe respekt dëshmorët e atdheut, në rradhët e të cilëve prehen dhe efektivë të Forcave të Armatosura.

Në ceremoninë zyrtare të organizuar me këtë rast morën pjesë presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, kryetari i Kuvendit z. Gramoz Ruçi, kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, politikanë e zyrtarë të tjerë. Personalitetet më të larta të shtetit kanë kryer homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule përpara memorialit "Nënë Shqipëri", në nderim dhe shenjë respekti për sakrificat e dëshmorëve që dhanë jetën për lirinë e Atdheut.

Më pas, ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Flamur Hadushi, komandanti i Bazës Ajrore

Farkë kolonel Kuto Hasani, ushtarakë të Forcës Ajrore, veteranë të Aviacionit si dhe familjarë të dëshmorëve bënë homazhe dhe vendosën buqeta me lule pranë varrit të dëshmorëve më të fundit të atdheut, kapiten Feti Vogli, kapiten Florian Delia dhe toger Donald Hoxha të rënë në krye të detyrës. Në nderim të veprës e sakrificës së pilotëve dhe teknikëve të FAJ u vendosën karafila e kurora me lule edhe nga Komanda e Forcës Ajrore, shoqata "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit", "Shoqata e Aviatorëve të Shqipërisë", ushtarakë të Forcës Ajrore, veteranë të aviacionit si dhe familjarë të dëshmorëve. Ministrja e Mbrojtjes znj. Xhaçka dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Kollçaku u takuan me familjarët e të rënëve, të cilëve u shprehën respekt dhe mirënjohje për vetmohimin e sakrificat e bijve të tyre për detyrën dhe atdheut.

Ndër dëshmorët që prehen në ato varreza, gjenden 33 efektivë të Forcave të Armatosura, 32 prej të cilëve pilotë dhe kapiten Feti Vogli.



Në rajonin e Gjirit të Vlorës

Zhvillohet stërvitja "Vlora SAREX 18"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, mori pjesë më 4 maj në Stërvitjen "Vlora SAREX 18" zhvilluar nga Forca Ajrore në rajonin e Gjirit të Vlorës me pjesëmarrjen e efektiveve të Forcës Ajrore, Forcës Detare, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Qendrës Kombëtare të Kërkim - Shpëtimit, si dhe strukturave të tjera bashkëvepruese e koordinuese në stërvitje.

Në këtë stërvitje ishin të pranishëm gjithashtu zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Manushaqe Shehu, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, komandantë të forcave dhe drejtorë të drejtorive në SHP

Stërvitja "Vlora SAREX 18" ishte dinamike për vetë faktin se Forca Ajrore mori pjesë me një helikopter "Cougar" për operacionet e kërkim-shpëtimit dhe një helikopter EC 145 për shpëtimin e të mbijetuarve e transportimin e tyre në breg apo drejt ambienteve spitalore, ndërsa Forca Detare mori pjesë me anijen "Iliria"/"Lissus", Repartin e Zhytjes, si dhe Qendrën Shëndetësore Pashaliman.

Qëllimi i stërvitjes ishte rritja e aftësive operacionale të strukturave përgjegjëse për shërbimin SAR (Search And Rescue) në procesin e planëzimit, bashkëpunimit, koordinimit dhe zhvillimit të operacioneve të kërkim - shpëtimit në det.

Stërvitja u zhvillua në bazën e një skenari, ku një mjet ajror 5-6 persona në bord gjatë realizimit të detyrës si ambulancë ajror e ka pësuar defekt në motor. Kërkohet ndihma e institucioneve shtetërore për gjetjen e të humburve dhe dhënien e ndihmës për shpëtimin e personelit nga mbytja.

Në fjalën e tij në përfundim të stërvitjes gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku vlerësoi rëndësinë e kësaj stërvitje, bashkërendimin e veprimeve komplekse të strukturave tokë-ajër-det si dhe njëkohësisht theksoi se: "... stërvitje të tilla testojnë kapacitetet që ka Forca e Armatosur, gatishmërinë dhe profesionalizmin". Gjithashtu, ai inkurajoi vijimin e konsolidimit të aftësive operacionale të strukturave përgjegjëse të shërbimit SAR në procesin e planëzimit, koordinimit, bashkëpunimit dhe zhvillimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit në det me qëllim për t'i ardhur në ndihmë situatave të vërteta në raste të operacioneve të kërkim-shpëtimit, fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile".

Morën pjesë Forca Ajrore, Forca Detare, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit (QKKSH), si dhe të gjitha strukturat bashkëvepruese në stërvitje



Shqipëria afër anëtarësimit në IHO



Projekti shqiptaro - norvegjez ALNO-HIP

Kapiten i rangut të I-rë Arsen Mulla takohet me drejtorin e projektit Z. Evert Flier

Paraditen e ditës së enjte, datë 3 maj, shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut të I-rë Arsen Mullaj, zhvilloi një takim me drejtorin e projektit të përbashkët shqiptaro-norvegjez ALNO-HIP, Z. Evert Flier. Gjatë takimit u diskutua ecuria e projektit ALNO-HIP, trajnimin e personelit të Shërbimit Hidrografik sipas standarteve të International Hydrographic Organization (IHO) në fushën e hidrografisë si dhe realizimi i matjeve hidrografike dhe përpunimi i tyre, të cilat ruhen dhe mbahen në databazën e të dhënave batimetrike. Gjithashtu temë kryesore e takimit ishte përgatitja dhe realizimi i takimit të sekretarit të Përgjithshëm të IHO-s me kryeministrin e vendit tonë në një periudhë të afërt për të siguruar mbështetjen e anëtarësimit të Shqipërisë në IHO.

FORCA TOKËSORE



Kimistët pastrojnë ish-uzinën e baterive në Gramsh

Prej disa ditësh, Kompania e Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë e Forcës Tokësore (KMADMFT) është duke zhvilluar një operacion, për ripaketimin e mbi 15 ton blözë baterish në ish-uzinën e baterive në Gramsh dhe dërgimin më pas në grup depot e Elbasanit.

Ndërhyrja në këtë zonë, ishte bërë imperative, kjo për shkak të rrezikshmërisë së lartë që paraqisnin këto materiale, jo vetëm për banorët e zonës, por edhe për ekosistemin në tërësi.

Operacioni drejtohet nga komandanti i KMADMFT major Florenc Veliu dhe synon të përfundojë brenda një kohe të shkurtër. Kompania që drejton major Veliu, është nënreparti më i specializuar që disponojnë Forcat e Armatosura, për operacione të kësaj natyre. E trajnuar prej shumë kohësh nga ekspertët ushtarakë amerikanë, nënreparti zotëron pajisjet e fjalës së fundit të teknologjisë në fushën e MADM.

Pastrimi i ish-uzinës së Gramshit, nga materialet toksike dhe kimike, vjen jo shumë kohë pas realizimit me sukses të një tjetër misioni nga kimistët e Forcës Tokësore, siç ishte operacioni për pastrimin e mbetjeve kimike, në ish-godinën e Institutit të Studimeve Teknologjike të Ndërtimit (ISTN), Tiranë

“Modernizimi i FA-ve është një sfidë e përditshme”

(vijon nga fq. 4)

Për hir të së vërtetës nuk e kam as këtë informacion që po citoni ju, por të jeni të bindur që të paktën në ushtri, historia e disiplinës, e komandës dhe e hierarkisë, funksionon në mënyrën më të mirë të mundshme. Edhe nuk ka lëvizje të ministrit, që anashkalojnë hierarkinë: gjeneralët, kolonëlët, komandantët apo këdo, i cili është në atë piramidë, sikundër, nuk ka veprime të tjera, të cilat anashkalojnë ministrin.

Më vjen mirë dhe ju e dini, e kaluara ka treguar që është anashkaluar pjesa e gjeneralëve. Për shembull rasti i Gërdecit është një rast i pastër ku ajo pjesë ishte e anashkaluar. S'dua të bëj ndonjë analogji, por komunikimi po thoni është i ndërsjellët mes jush dhe pjesës ushtarake.

Shiko nuk kemi të bëjmë për gjëra të kësaj natyre, ndaj them që analogjia nuk qëndron. Në mandatin tim, bashkë me shefin e ri të Shtabit kemi pasur një fokus shumë të veçantë tek trajtimi i mirë dhe tek meritokracia, që do të thotë: trajnim, edukim edhe përparim në karrierë sipas meritës. Në këto kushte, me këtë moto, me këtë filozofi, nuk ka vend për të anashkaluar askënd, por ka shumë vend për të krijuar sinerji në marrjen e vendimeve të përbashkëta, sigurisht duke respektuar hierarkinë, duke respektuar disiplinën ushtarake, duke respektuar misionin e FA dhe gjithë sa mund të bëjmë për t'i ardhur në ndihmë komunitetit që në fakt është një shtojcë e misionit tonë për t'i shtuar sigurisë dhe mbrojtjes së përbashkët.

Znj. Ministre nëse mund t'iu pyes pak për infrastrukturën e Forcave tona të Armatosura. Si është cilësia e bazave tona ushtarake? Janë të mirëmbajtura, i kemi në gjendje të mirë pune apo ka probleme?

Mos harroni, jemi një vend anëtar i NATO dhe kemi standarde shumë specifike për të mbërritur edhe për të pasur. Jemi një forcë operationale, e cila modernizimin dhe përparimin e saj në shumë dimensionet e ka një sfidë të përditshme, por kjo nuk do të thotë që nuk jemi sot të aftë për të qenë realisht një partner i denjë dhe jemi në partner i denjë, i cili ka treguar që me një forcë, e cila është e mirëtraajuar, e mirëedukuar, e mirëpajisur ka qenë e ndërveprueshme krahas aleatëve tanë në shumë operatione dhe misione. Sot jemi në Kosovë, vjet dyfishuam kontributin tonë në KFOR. Sot jemi në Afganistan. Sërisht ka pasur një kërkesë të aleatëve dhe po dyfishojmë kontributin tonë në Afganistan. Sot jemi në Letoni ku përfaqësohemi me një kontingjent shumë dinjitoz. Sot jemi në detin Egje me një anije patrulluese, e cila është atje për vitin e saj të dytë duke sjellë një precedent shumë pozitiv edhe për Forcën Detare, e cila nuk ka qenë më parë e përfshirë në të tilla operatione jashtë vendit; sot jemi në Mali jemi në Bosnje-Hercegovinë..

Në çfarë operationesh marrin pjesë, meqë përmendët Egjeun?

Është një anije patrulluese, e cila ka shpëtuar më shumë se 1000 emigrantë, të cilët vijnë nga Lindja e Mesme ose nga Afrika, me gomone për të kapur brigjet e Turqisë apo të Greqisë. Forcat tona kanë shpëtuar sot jetën e mbi 1000, ndoshta për të qenë më preciz 1200 nënave, fëmijëve, kryesisht emigrantë që vijnë nga vendet e Afrikës. Nëna, fëmijë, burra, djem, vajza, të cilët lufta, pamundësia dhe kushtet jashtëzakonisht të vështira i detyrojnë që të marrin një rrugë jashtëzakonisht të vështirë. Forcat tona, anija jonë patrulluese ka pasur një kontribut të jashtëzakonshëm, të përgëzuar nga të gjithë aleatët tanë.

Një pyetje të fundit përsa i përket



raportit me ushtrinë, meqenëse folëm për gjeneralët. Po marrëdhëniet me komandantin e Përgjithshëm të FA që është edhe presidenti, si i keni? A keni komunikim me të?

Patjetër, kam pasur komunikim me të. Ka qenë një komunikim shumë korrekt për detyrat tona të ndërveprueshme.

Keni komunikim periodik apo vetëm kur ka shqetësime nga Presidencia, ose nga ju?

Kemi komunikim periodik. Komunikim përmes Komisionit të Sigurisë, që do të zhvillohet tani shpejt, kemi komunikim për gradimet të gradave “gjeneral”. Kemi komunikim të vazhdueshëm për çështje të ushtrisë për të cilat presidenti duhet të jetë gjithmonë i njohur.

Pyes, sepse më parë ka pasur probleme midis dy institucioneve, besoj ju e dini?

Ka pasur një komunikim institucionel shumë korrekt.

Për të folur në këtë pjesë të dytë edhe pak politikisht me ministren Olta Xhaçka, e cila është edhe anëtare Kryesisë së Partisë Socialiste. Përpara se të vijojmë me këtë pyetje, do të ndjekim një material se çfarë ka ndodhur. Zonja Ministre duket se këto asamble po kthehen në pak të frikshme politikisht, në sensin që edhe juve, apo e prisnit këtë fjalim të ashpër të kryeministrit?

Shiko kjo ka qenë filozofia e kryeministrit që nga dita e parë që unë kam punuar në Kabinetin e tij.

Edhe në Asambledën e Shtatorit shumë nuk e dinin që do ishin edhe kandidatë për ministra, apo jo?

Kjo nuk ka lidhje fare. E rëndësishme është që kjo filozofi e ka shoqëruar kryeministrin që nga dita e parë. Unë nuk di të ma ketë bërë këtë detyrë fushë me lule, përkundrazi, më ka thënë që do të jem personalisht në një sfidë të përditshme, për të shpërblyer besimin që më ka dhënë jo ai, por besimin që na kanë dhënë votuesit, në Zgjedhjet e Shkuara Parlamentare për të qenë këtu dhe, për të bërë atë, që ata presin nga ne. Sigurisht, kjo nuk është e lehtë për një vend që ka shumë pamundësi, nuk është e lehtë për një buxhet që është shumë më pak nga çdo donim të ishte për të adresuar për ato sfida që janë emergjente në shoqërinë tonë e, megjithatë, ky nuk është justifi-

kim që ne të mos bëjmë maksimumin tonë si të zgjedhur, si të besuar në këto detyra për të përmbushur pritshmëritë që votuesit kanë nga ne. Në këtë filozofi mua nuk më bën habi kjo retorikë e kryeministrit, e keni dëgjuar edhe në të shkuarën, por sot, duket sikur po thotë një gjë të re në fakt por esencialisht e ka thënë vazhdimisht këtë gjë edhe e ka bërë edhe përpara zgjedhjeve, edhe përpara mandatatit të dytë.

Dakord, por Qeveria nuk ka as 6 muaj zonja ministre...

Ka pasur dhe një mandat të parë, ky është mandati i dytë. Edhe para mandatatit të dytë kemi parë disa fushata llogaridhënie të të gjithë të zgjedhurve deri dhe tek Kabineti. Unë nuk e di



nëse ka arsye për t'u riparë Kabineti në shtator, ndoshta rishikohet, ndoshta nuk rishikohet. Por di që kemi një kontratë, gjithsecili prej nesh me kryeministrin, me disa objektiva shumë ambiciozë për të mbërritur; e kemi firmosur atë kontratë dhe kemi marrë përsipër që do të bëjmë atë që kemi thënë se do të bëjmë. Besoj se është mjaftueshëm arsye për të vlerësuar se si kemi bërë punën në krye të një viti, se sa kemi përmbushur nga ato objektiva që kemi marrë përsipër edhe nga ai plan - pune që kemi marrë përsipër për të kryer, sigurisht për të shpërblyer besimin e madh dhe për të bërë atë punë që shqiptarët presin.

Megjithatë ju a ndiheni pak në presion nga këto fjalë të kryeministrit, duket sikur deri në shtator do jeni disi në ankth? Se, gjithëçka është në dorën e një individi, të kryeministrit dhe kjo nuk është aq demokratike. N.q.s. ai mendon se ka nevojë për ndryshime do ju heqë, n.q.s. jo, atëherë, do qëndroni ministre? A është normale kjo?

Pa diskutim! Ai ka përgjegjësinë, ai

ka lidhur një kontratë me Kabinetin e vet, ne jemi të përzgjedhurit e tij për të çuar përpara vizionin e tij dhe të qeverisë së tij. Nëse jemi të paafte për të çuar përpara vizionin e tij, pa diskutim që dikush tjetër më i aftë duhet të marrë përsipër këtë detyrë. Nga ana tjetër ju më pyesni se a ndjehem në presion? Po ndihem në presion dhe ndjehem në presion çdo ditë, siç jam e bindur se dhe kolegët e mi ndihen, por jo kundrejt kryeministrit, sepse nuk diskutohet fati individual i ministrave, të Ramës, as fati individual i secilit prej nesh për të qenë o ministër o rashë e vdiq, këtu diskutohet përgjegjësia e jashtëzakonshme mbi shpatullat e gjithsecilit prej nesh që për të çuar përpara një vizion, që çon përpara Shqipërinë; që na afron më shumë me aspiratat e shqiptarëve; që çon përpara ato interresa madhore të të gjithëve ne, përmes një

politik bërjeje shumë më të përgjegjshme, shumë më të zotë, shumë më të aftë dhe shumë më afër interesave të qytetarëve. Ky është presioni që ndjej përditë. Nëse nuk mund të bëj dot këtë, fati im nuk ka ndonjë konsequencë të jashtëzakonshme.

Më vjen mirë që e merr kaq lehtë pasi politika në fund të fundit kështu duhet të jetë...gjë normale... Po punën e kryeministrit kush e gjykon?

Punën e kryeministrit e gjykojnë votuesit, e gjykojnë çdo 4 vjet kur votojnë për vizionin e tij qeverisë për objektivat e tij programorë, për ku do ta çojë vendin, çfarë do t'u afrojë shqiptarëve, si do çojmë përpara aspiratat e mëdha si do ta integrojmë Shqipërinë sa më parë në familjen e madhe europiane, si do ta zhvillojmë këtë vend më shumë, si do ta zhvillojmë dhe do ta rrisim ekonominë më shpejt, si do hapim më shumë vende pune dhe, për të gjitha ato, që janë probleme të përditshme të shqiptarëve. Sigurisht, kryeministri është personi, i cili është nën skrutinitetin, nën lupën e të gjithëve. Ndërsa gjithsecili prej nesh,

fati ynë a ministër, apo deputet është krejt pa konsequencë në lëmin e madh të interesave dhe aspiratave të shqiptarëve dhe të asaj që presin prej nesh si qeveri. Dhe besoj se kjo është gjëja që duhet të na shqetësojë maksimalisht më tepër se sa fati i njërit apo tjetrit.

Pra ju nuk jeni e shqetësuar edhe nëse në shtator kryeministri vendos shkarkimin tuaj?

Unë besoj se jam në këtë detyrë, jam në këtë parti, mbështes këtë kryeministër për arsyet e duhura dhe arsyet e duhura nuk janë ambicia ime profesionale është dëshira për të qenë bashkë dhe për të bërë më të mirën për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Megjithatë zonja Ministre ne nuk jemi aktualisht në fushatë. Por ju e keni nisur fushatën, që ju e quani llogaridhënie, por shumë kush mund ta interpretojë edhe si nisje e fushatës elektorale për zgjedhjet lokale. Çfarë është kjo fushatë dhe normalisht, në çdo vend të BE, normalisht marr atë që kanë standarde dhe që janë, një qeveri që merr votëbesimin nuk duhet të bëjë fushatë, ju çfarë bëni aktualisht?

Po, japim llogari.

Por llogari qeverie ka në katër vjet?

Jo, nuk jepem njëherë në 4 vjet. Jepem në mënyrë të vazhdueshme dhe ndoshta ajo protesta e Kukësit ka evidencuar disa problematika që të gjithë po i adresojmë. I keni dëgjuar edhe nga kryeministri, i keni dëgjuar edhe nga ministrat e linjës, sigurisht do ta dëgjoni nga gjithsecili prej nesh, që nuk ka më vend për mungesë transparence. Nuk do të ketë lodhje për të njoftuar, për të sensibilizuar për të informuar shqiptarët për të gjitha këto që po bëjmë dhe të gjithë këto vendime të marrën bashkë, që këto vendime të jenë kolegjiale dhe që ata të kuptojnë se çfarë hapash po ndërmarrim dhe ku duam ta çojmë këtë vend dhe ku do na nxjerrin hapat që po ndërmarrim. Dhe kjo nuk është një fushatë, se nuk po bëjmë një fushatë me kundërshtarë përballë, se nuk ka afruar akoma, është shumë larg edhe fushat për pushtetin vendor, është thjesht një fushatë llogaridhënie për gjithë sa kemi bërë, në këtë 6 - muaj. Këtë analizë e kemi bërë edhe si ministra në Kryeministri, e kemi bërë edhe para grupit parlamentar, e kemi bërë edhe në rrethe më të gjera.

Atëherë çfarë meraku keni që e bëni këtë? Keni merakun se nuk ju besojnë më qytetarët, që duhet kjo llogaridhënie?

Jo, nuk ka lidhje fare. Kjo është përgjegjshmëri. Thjesht përgjegjshmëri. Japim llogari për gjithë sa kemi bërë dhe marrim inputin e tyre për çfarë mund të bëjmë më mirë. Është kaq e thjeshtë. Llogari. Një analizë 6 - muajore nëse doni ti vini një emër banal. Një analizë 6-mujore. Llogaridhënie, dialog, komunikim me qytetarët. Kaq është sa kemi bërë, këto ishin mundësitë dhe pamundësitë, na gjykoni nëse kemi bërë mirë apo ka më tepër për të bërë. Edhe na jepni rekomandimet tuaja se si mund ta bëjmë më mirë. Çfarë do donit të bënim ndryshe! Një fushatë intensive komunikimi dhe llogaridhënie.

Po i jepni më shumë rëndësi zonja Xhaçka partisë se sa qeverisjes? Pra

AKADEMIA E NËNOFICERËVE

25 kursantë përfundojnë Kursin e 18 të Lartë të Nënoficerit

Në datën 4 maj 2018 në sallën e mbledhjeve të Akademisë së Nënoficerave u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Lartë të Nënoficerit. Kursi i 18-të i lartë i Nënoficerit filloi me datë 19 mars 2018 dhe mbaroi në 4 maj 2018 me 25 (njëzet e pesë) kandidatë sipas listës së miratuar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, nga të cilët 25 (njëzet e pesë) arritën ta përfundonin me sukses kursin.

Kursi i lartë i Nënoficerit mbështetet në konceptin arsimor ushtarak për nënoficerët si dhe integrimin e pjesmarrësve në procesin mësimor duke synuar zhvillimin e aftësive profesionale të tyre në rolin e këshilltarit dhe specialistit në shtabin e nënrepartit dhe të repartit. Programi mësimor i kursit të Lartë të

Nënoficerit është i fokusuar në aftësimin e nënoficerit në realizimin e kërkesave të funksionit organik të kapterit në kuadrin e strukturës organizative të FA-së. Kursi i Lartë i Nënoficerit u zhvillua në ANO për një periudhë 8-javë, i fokusuar në lëndët Formim Politik, Rregullore/Ligjshmëri, Drejtim Komandim, Metodikë-didaktikë, Informatikë, Histori Ushtarake, Administrim, Taktikë, SHLT, Përgatitje Zjarri, Përgatitje Fizike.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm, Komandanti i ANO Kolonel Albert Mullai, zv.Komandanti i ANO N/Kolonel Muhamed Guza, Komandanti i Kurseve N/Kolonel Shkwlqim Alsela. Në fjalën e tij përshëndetëse Komandanti i ANO Kolonel Albert Mullai theksoi: "Kjo ceremoni sot dëshmon punën e bërë nga ju dhe instruktorët tuaj për të arritur nivele më të larta, krahasuar këto me njohuritë tuaja para se ta fillonit kursin. Ajo që ka rëndësi është dëshira, vullneti dhe përkushtimi juaj i vazhdueshëm për tu përmirësuar dhe aftësuar gjithmonë e



më tepër si specialist në shtabe, këshilltar komandatësh, si nënoficer i denji i FA. Ndaj do të kërkoja nga ju që njohuritë e marra në ANO ti përditësoni akoma dhe më shumë nëpërmjet literaturës ushtarake, nëpërmjet informacioneve të ndryshme zyrtare në internet e kudo tjetër për tu rritur e zhvilluar më tej si ushtarakë, por në rradhë të parë si qytetarë të këtij vendi.

Në fjalën e tij, Komandanti i Kursit

të Lartë Major Agron Elmasllari theksoi: "Më lejoni që të bëj një falenderim të vecantë për të gjithë ju, pasi secili nga ju shpalosi vlera jo vetëm duke dhënë shëmbullin personal por tregoi edhe aftësitë e tij për punën dhe bashkëpunimin në grup, element ky mjaft i rëndësishëm për aftësimin dhe krijimin e shprehive praktike për të përballuar ngarkesat dhe kërkesat për realizimin e detyrave si këshilltar dhe specialist në shtabin e

nënrepartit dhe të repartit'.

Në fjalimin e mbajtur në emër të të gjithë kursantëve, Rreshter Majlinda Nebollaj falenderoi të gjithë trupën mësimdhënëse të ANO-së, që "me shumë profesionalizëm, këmbëngulje dhe durim na mësuam, stërvitën dhe na bënë që të ndjehemi më të sigurt në detyrat që do të na besohen në të ardhmen. Ne sot jemi gati për të vazhduar më tej".



STËRVITJA
"ALBANIAN-LION 2018"

Ushtarakë britanikë në Komandën e Forcës Detare

Të mërkurën, më 9 maj, para-ditë Shefi i Shtabit i Forcës Detare, Kapiten i Rangut të I-rë Arsen Mullaj, zhvilloi një takim me ushtarakë britanikë, pjesë e grupit koordinator për stërvitjen "Albanian-Lion-2018". Qëllimi i këtij takimi ishte planëzimi dhe përcaktimi i masave paraprake dhe bashkëpunimi me Komandën e Forcës Detare për zhvillimin normal të stërvitjes "Albanian-Lion 2018", vjeshtë e këtij viti.

Fëmijë durrsakë vizituan Komandën e Forcës Detare

Dhjetra fëmijë të shkollës "Eftali Koci" në Durrës ishin ditën e mërkurë, më 9 maj, mysafirë në Komandën e Forcës Detare. Dëshira për të vizituar anijet dhe për tu njohur me zanatin e bukur të detarit, i solli këta vizitorë të vecantë në ambientet e jashtme të Komandës. Shefi i Shtabit i Forcës Detare, Kapiten i Rangut të I-rë, Arsen Mullaj i foli vogëlushëve durrsakë për anijet me të cilat lundrojnë marinarët e Flotës Luftarake dhe i shpjegoi profesionin e bukur të detarit. Vogëlushët durrsakë, disa prej të cilëve fëmijë marinarësh panë me kërshtëri disa tipe anijesh të përdorura në vitë nga detarët tanë dhe shijuan një ditë ndryshe nga aktiviteti i tyre ditor në shkollën "Eftali Koci".



KOMANDA MBËSHETËSE



Forcat e Armatosura zhbllokojnë aksin Bogë-Theth

Pas më shumë se 5 muaj i bllokuar, aksi nga fshati Bogë deri në Theth në bashkinë e Shkodrës bëhet i kalueshëm. Mjetet dhe efektivët e Komandës Mbështetëse, me mbështetjen edhe të bashkisë së Shkodrës, hapën plotësisht aksin prej 22 km nga Boga deri në zonën turistike të Thethit.

Trashësia e borës në pjesë të caktuar të këtij aksi arrinte deri në 5 m për shkak pozicionit gjeografik dhe grumbullimit të borës nga era.

Hapja më herët e rrugës ishte e pamundur për shkak të rrezikut të krijimit të ortekëve, të cilët jo vetëm do të bllokoni sërish rrugën, por edhe do të rrezikonin seriozisht jetën e udhëtarëve.

Ndërhyrja e Forcave të Armatosura në këtë aks të bllokuar që prej muajit dhjetor të vitit të kaluar, jo vetëm nxjerr nga izolimi banorët e zonës turistike të Thethit, por gjithashtu mundëson ardhjen e turistëve vendas e të huaj.

Përgatiti: MSC. MIMOZA GOLIKJA

OPINION

A do të zbulojë Aleanca anijet përsëri?

Opinionin që po sjellim sot në faqet e shtypit ushtarak, (sipas burimeve të NATO-s), është një material kritik i Profesor Peter Roberts. Profesor Roberts është Drejtor i Shkencave Ushtarake dhe i Shkencave të Larta në Institutin Mbretëror të Shërbimeve të Bashkuara për Studime të Mbrojtjes dhe Sigurisë, një think tank global me bazë në Londër.



të ideve dhe idealeve me emëruesin më të ulët të përbashkët në të cilin të gjithë anëtarët mund të pajtohen. Rezultati i një qasjeje të tillë mund të ketë pak dobi si një pengesë, nëse futja, siç ishte Strategjia Detare e Aleancës 2011, ishte veprim policor (siguria detare) ose kundër terrorizmit, fusha në të cilat të gjithë pajtohen, dhe jo një strategji specifike parandaluese. Në të vërtetë, të dy aktivitetet e Rusisë dhe aftësitë që po zhvillohet kërcënojnë të gjitha shtetet në Aleancë, jo thjesht ato në grupin e Veriut.

Aftësitë ushtarake ruse, çfarë ka të re?

Duke pasur parasysh veprimet ruse në Detin Baltik, atë Norvegjisë, Atlantikut të Veriut, Detit të Veriut, Egjeut, Detit të Zi, Mesdheut Lindor dhe Detit të Kuq, çdo strategji e re detare duhet tu përgjigjet pyetjeve se si të merret me Rusinë në det si fokusin e saj primar, Aleanca, dhe Komanda e Re Atlantike, një qëllim bindës i aftë për të galvanizuar të gjitha marinat për shkakun e saj.

Moska ka financuar, dorëzuar dhe testuar sulme të reja tokësore dhe sisteme raketash të sulmeve detare, vargje të reja të sensorëve, platforma të reja dhe taktika të reja, të cilat duket se kanë vjedhur çdo Offset të Tretë të supozuar që Perëndimi shpresonte të zhvillohej. Këto aftësi janë të dizajnuara për t'u përdorur në zhvillimin e luftës me intensitet të lartë. Rusia duket se i përdor këto nën pragun e luftës, qoftë hibride, luftime të re gjeneruese, ose përmes një versioni të përditësuar të masave aktive.

Rusia ka një buxhet relativisht të vogël të mbrojtjes, sigurisht në krahasim me NATO-n në përgjithësi. Në çdo llogaritje të një korrelacioni të forcave, Aleanca me siguri ka një avantazh të rëndësishëm në letër. Megjithatë, forcat e armatosura ruse kanë sukses shumë më të madh në fushën e betejës sesa NATO; mund të thuhet se kjo ka rezultuar me ndikim më të madh politik dhe të levave nga Afrika Veriore në Lindjen e Mesme.

Pozita agresive dhe aktivitetet e Rusisë në Balltik, Ballkan, Arktik, Siri dhe Ukrainë janë të njohura. Aftësitë e reja ushtarake që demonstrohen dhe testohen në Siri janë stimulimi i shitjes së armëve në Lindjen e Mesme dhe Paqësori, si dhe me aleatët e NATO-s. Më pak të kuptuara janë lëvizjet nga Rusia në Ballkan dhe

prania e saj aktive në Skandinavi: një doktrinë e provuar mirë dhe e testuar e spiunazhit, mashtrimit, nënshtrimit dhe sabotimit që kërkon të minojë ideologjinë perëndimore, kohezionin e NATO-s dhe kredibilitetin e Aleancës.

Në det, Rusia është në procesin e rindërtimit të forcave të saj detare. Mosha dhe gatishmëria e anijeve të saj në të gjithë flotën e Detit të Veriut, Paqësorit, Detit të Zi, Detit Baltik dhe Kaspikut nuk janë më të këqija se ato të NATO-s, megjithatë programi i ndërtimit është agresiv dhe ambicioz, duke u fokusuar në aftësitë luftarake me intensitet të lartë me ujë blu. Shpërndarja e 100 anijeve shtesë (54 luftarake të mëdha) dhe nëndetëseve (24 konte konvencionale dhe bërthamore) të planifikuara para vitit 2020 do të jenë sfida, por është një dizajn force koherente që do të vazhdojë të sfidojë fuqinë detare të NATO-s për të paktën dy dekada.

Ekzistojnë tre aspekte të dukshme të zhvillimit të forcave detare ruse. Së pari, zhvillimi i vazhdueshëm i programit të nëndetëses ruse, duke kombinuar sisteme autonome me platformat tradicionale me njerëz. E dyta është evolucionin e teknologjisë raketore ruse, duke mbuluar sulmin tokësor, sulmin detar, lundrimin dhe sistemet balistike me rreze të shkurtër të aftë për të mbingarkuar ose mposhtur mbrojtjen perëndimore.

Së fundi, është e qartë se forcat ruse nuk po investojnë thjesht në aftësi dhe teknologji të reja. Përkundrazi duket se ato shohin mundësi në kombinimin e teknologjive me vullnet të lartë politik, një aftësi për të vepruar në mënyrë të paparashikueshme dhe për të menduar jashtë NATO-s. Statusi i sistemit të shumë qëllimeve të Oqeanit të Rusisë-6 është një shembull i mirë i kësaj, duke kombinuar autonominë, njohurinë e armëve, ekspertizën nënujore dhe hilen e ulët në një kombinim potencialisht vdekjeprurës. Ai është një konkurrent i qartë për ngarkesat e larta të DARPA-s që bien.

Statusi-6 i sistemit të shumë qëllimeve të Oqeanit të Rusisë është një shembull i mirë i kësaj, duke kombinuar autonominë, njohurinë e armëve, ekspertizën nënujore dhe hilen e ulët në një kombinim potencialisht vdekjeprurës. Ai është një konkurrent i qartë për ngarkesat e rënies të DARPA-s.

Ky koncept i luftës, marshimi i vullnetit të lartë politik me paparashikueshmëri gjeografike, njohja e fushave

kyçe dhe gatishmëria për të vepruar jashtë rregullave të angazhimit perëndimor (ligjërisht, dhe moralisht), është një sfidë e veçantë për komandantët politikë dhe ushtarake në NATO. Duke ushtruar qasje hibride, gri ose pragu për aktivitetet që nuk kanë konflikt, Rusia e ka marrë iniciativën në tokë dhe po e bën këtë edhe në det.

Moska tani mund të prishë aftësitë e shteteve evropiane, me kërcënimin e kabllëve nënujore (energji, internet dhe ujë), aktivitetet të peshkimit dhe tregtisë, rrugët e Arktikut dhe potencialisht diktimitin e ritmit dhe shkallës së flukseve të migracionit. Njëkohësisht, forcat ajrore ruse, sipërfaqësore dhe nëntokësore shpërqendrojnë dhe shfrytëzojnë komandat, nga shikimi i tërësisë së pamjes. Veprimet në Atlantik, nën akullin në Arktik, Egjeun, Detin e Zi, Baltikun dhe Mesdheun janë të gjitha të lidhura me mendimin rus. Është një plan koherent dhe mjeshëror, nëse është disi oportunist në karakter.

Një përgjigje e pamjaftueshme e Aleancës

Si përgjigje, Aleanca e ka rritur fokusin e saj në fushën detare. Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s ranë dakord nëntorin e kaluar për të përfunduar qëndrimin detar të Aleancës si një komponent integral i forcimit të qëndrimit të saj parandalues dhe mbrojtës. Kjo duhet t'u mundësojë aleatëve, deri në kohën e Samitit të Brukselit 2018, të marrë vendime për mënyrën se si forcat dhe aftësitë detare janë të urdhëruara, ushtruar dhe të punësuara, duke përfshirë për zhvillimin e luftës. Por këto veprime vetëm se nuk janë të mjaftueshme, dhe as nuk adresojnë supozimin e Aleancës se sa më shumë informacion është i barabartë me suksesin. Besimi se më shumë informacion do të jetë vendimtar rrjedh nga Plani 1919 i JFC Fuller, në të cilin kapërcimi i udhëheqjes vepron si një "plumb në tru" të një armiku dhe fiton luftën. Shpejtësia, manovrimi dhe surpriza kanë qenë thelbësore për doktrinën e NATO-s që nga vitet 1980 dhe disinvestimi në forcat ushtarake që nga viti 1990 ka bërë të domosdoshme nevojën për t'u bërë gjithnjë e më eficient në përdorimin e platformave të pakta për t'u përshtatur armikut.

Informacioni është shfaqur si kërkesë kryesore në zbatimin e një strategjie të tillë bazuar në supozimet e Fuller. Si rezultat, dizajni i forcave të NATO-s është bërë gjithnjë e më i varur nga informacioni, me komandim dhe kontroll më të centralizuar në çdo nivel. Rusia e njohu këtë si dobësinë e NATO-s në Luftën e Gjirit të 1991 dhe që nga viti 2003 ka investuar vazhdimisht më shumë se 20 për qind të buxhetit vjetor të mbrojtjes në luftën elektronike dhe mjetet kibernetike të aftë për të thyer lidhjen në të cilën mbështeten doktrina dhe komandantët e NATO-s.

Tani nevojiten zgjidhje efektive që kontribuojnë në parandalimin "modern" ose "të përshtatur", jo më shumë letra, politika dhe strategji të papërfillshme. Do të ishte mjaft e dobishme për Aleancën të konsideronte se si do të pengojë ambicjet e Moskës në det: të mbeten reaktive ose të

marrin iniciativën? Kjo mund të jetë në një zonë gjeografike ku forcat ruse shkojnë të pakontrolluar si nën akull në Arktik, ose në një fushë që Moska kujdeset, për shembull, në Mbrojtjen e Raketave.

Përballimi i forcave detare të Rusisë në një platformë për platformë është një konsideratë e denjë. Kjo do të kërkonte që forcat detare perëndimore të zhvendoseshin nga doktrinat e ekspeditës në bazë të platformave të projektimit të energjisë elektrike, në atë që mbështet luftëtarët sipërfaqësorë dhe nëndetëset, me investime më të mëdha të vendosura nga Aleanca në tërësi në luftën detare.

Taktikat gjithashtu duhet të adresohen. Ndërsa procedurat e operimit detar të NATO-s janë përparuar me shpejtësi në fushën e sulmit në tokë, nuk ka pasur përparim të dukshëm në taktikat e luftës anti-nëndetëse (ASW) që nga vitet 1950. Aftësitë perëndimore në ujërat e thella ASW mund të përmirësohen por nuk kanë rifituar ekspertizën apo shkallën që ekzistonte në kulmin e Luftës së Ftohtë. Ky është një shqetësim. Sekretari i Shtetit Britanik për Mbrojtjen tha më 21 shkurt 2018 se kishte pasur një rritje të dhjetëfishuar të aktivitetit nëndetës rus. NATO aktualisht nuk ka trajnim të mjaftueshëm, taktika apo burime për t'i sfiduar ata në çdo fazë, edhe nëse ka vullnet politik për ta bërë këtë. Interesante është që një grup i ngjashëm problemesh është njohur nga Admirali Swift në PACCOM dhe rezultati ka qenë ri-shfaqja e problemeve të flotës. Stafi i Swift-it e kuptoi se trajnimi ishte bërë rregullues në dhënie e gatishmërisë efikase dhe prandaj dëmtoi kreativitetin dhe iniciativën e ekipazhit dhe shtabeve. Duke qenë i hapur ndaj lojërave më pak të planifikuara të luftës, Swift pretendon të ketë parë një ndryshim të thellë në performancën, letalitetin dhe origjinalitetin. Më e rëndësishmja, këto ushtrime kanë zbuluar dështime të mëdha në taktikat, teknikat dhe procedurat e USN-së, shumë prej të cilave janë të përbashkëta në NATO. Nuk ka asnjë fushë në të cilën Rusia është më mirë se NATO-ja, por qasja e tyre në kombinimin e teknologjisë, mënyrat e luftimit, platformat, armët, sensorët së bashku me një vullnet agresiv politik për të vepruar, i bën ata kundërshtarë sfidues. Nuk është aq shumë sa Rusia po fiton, por NATO po humbet betejën në det. Një përgjigje e re e NATO-s duhet të jetë aq e hapur, e kufizuar dhe e zgjuar sa qasjet e zhvilluara në Akademinë Frunze (Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm Rus).

Pyetja është nëse udhëheqësit ushtarakë perëndimorë kanë aftësinë për të përputhur ato aspirata, veçanërisht në fushën e ujërave të herta. Ndryshimi i strukturës së komandës mund të ndihmojë (por vetëm nëse ka burime të duhura me njerëzit e duhur), por një strategji e re detare nuk ka gjasa. Një plan dhjetë ose njëzetvjeçar është i admirueshëm, por sot marinarët, ushtarët, marinsat dhe aviatorët do të luftojnë me atë që kanë në dorë, jo fjalët e lavdërueshme në një copë letrë. Veprime dhe veprimtari reale kërkohen në det nëse Aleanca është serioze për të penguar Rusinë, sepse aktualisht është e dobët. Kjo është shumë për Komandën e re Atlantike për të ofruar

Estoni: 2-6 maj dhe 7-13 maj

15 mijë trupa në stërvitjen "Siil 2018"

Marrin pjesë forca ushtarake nga Mbretëria e Bashkuar, SHBA, Danimarka, Gjermania, Polonia, Franca, Letonia, Lituania, Belgjika, Kanada, Finlanda, Suedia, Gjeorgjia, Ukraina dhe Irlanda



Në këtë ushtrim marrin pjesë forca ushtarake aleate nga Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, Danimarka, Gjermania, Polonia, Franca, Letonia, Lituania, Belgjika, Kanada, Finlanda, Suedia, Gjeorgjia, Ukraina dhe Irlanda. Përveç forcave ushtarake, stërvitja sjell së bashku Ligën Vullnetare të Mbrojtjes Paraushtarake të Estonisë, Organizatën e Mbrojtjes të Drejtave të Gruas, si dhe punonjësit e policisë dhe të shpëtimit, për të trajnuar një mbrojtje të gjerë. Ushtrimi përqendrohet në manovrat mbrojtëse territoriale në kontekstin e luftës konvencionale dhe jo konvencionale, raportojnë burimet e NATO-s. "Roli i të gjithëve është i rëndësishëm, është thelbësore që shteti dhe qytetarët e saj të punojnë së bashku për të mbrojtur vendin," shpjegoi gjeneral Rico Terras, Komandant i Forcave Mbrojtëse të Estonisë.

Mbi 30 vëzhgues, përfshirë Rusinë dhe Bjellorusinë, si dhe nga OSBE dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, monitorojnë ushtrimin. Ushtrimi ndahet në dy faza. Gjatë fazës së parë, që zgjati deri më 6 maj, Liga e Mbrojtjes dhe Forcat e Mbrojtjes u stërviten së bashku për të arritur gatishmërinë luftarake. Kompanitë e lehta të këmbësorisë dhe njësitë e zbatimit të Ligës së Mbrojtjes trajtojnë detyra të brendshme të sigurisë me Policinë dhe Gardën Kufitare, duke përfshirë kryerjen e evakuimit të popullatës lokale, me mbështetjen e Or-

ganizatës së Mbrojtjes së Gruas. Faza e dytë ose faza e trajnimit të luftimit zgjat nga 7 maji deri më 13 maj, kryesisht në Võru, Põlva, Valgamaa dhe Latina Veriore. Në këtë fazë, brigada e dytë e

këmbësorisë së Estonisë, së bashku me aleatët dhe trupat partnere, stërviten në bashkëpunim kundër Brigadës së Pestë të Këmbësorisë dhe të njësisve luftarake të NATO-s.

GOTTEMOELLER NË BULLGARI:

Nderim për burrat dhe gratë e Ushtrisë së Bullgarisë

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s viziton Bullgarinë, takim me ministrat e mbrojtjes të BE

Nënsekretari i Përgjithshëm i NATO-s Rose Gottemoeller ishte në Sofje më 4 dhe 5 maj 2018 për të diskutuar reagimin e NATO-s ndaj sfidave aktuale të sigurisë, kontributet e Bullgarisë në Aleancë dhe bashkëpunimin NATO-BE. Gjatë vizitës së saj të parë në Bullgari si Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm, Gottemoeller u takua me kryeministrin Bojko Borisov dhe anëtarët e qeverisë së tij, si dhe nënpresidenten Iliana Yotova. Ajo i njohti ata me përgatitjet për Samitin e NATO-s i cili do të mbahet më 11-12 korrik. Siguria në rajonin e Detit të Zi, kontributi i Bullgarisë në misionet dhe operacionet e NATO-s, planet e shpenzimeve të mbrojtjes dhe qasja e NATO-s në Rusi ishin çështje që



gjithashtu u trajtuan në takim. Ditën e dytë të vizitës, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm mori pjesë në takimin e ministrave të Mbrojtjes të BE, të pritur nga Bullgaria si Presidencë e Këshillit Evropian takim që diskutoi Menaxhimin e krizave dhe Bashkëpunimin NATO-BE, veçanërisht në fushën e mobilitetit ushtarak. "Lëvizshmëria ushtarake është një

fushë ku interesat e organizatave tona konvergojnë në mënyrë të qartë dhe është thelbësore për të siguruar që përpjekjet tona janë koherente dhe plotësuese," nënvizoi Gottemoeller. Vizita erdhi gjithashtu edhe në prag të Ditës së Forcave të Armatosura Bullgare, e quajtur edhe Dita e Bravery, (caktuar më 6 maj), ku Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm falënderoi burrat dhe gratë që shërbejnë nën flamujt e Bullgarisë dhe NATO-s. Gottemoeller nderoi kontributet e vlefshme të Forcave të Armatosura Bullgare në Kosovë, në Afganistan dhe në Detin e Zi në Mesdhe. "Jam shumë e kënaqur që jam këtu në prag të kësaj festë të rëndësishme, për të nderuar burrat dhe gratë e Forcave të Armatosura të Bullgarisë", tha Gottemoeller.

Portugalia merr kryesimin e Policisë Ajrore Baltike

Forca Ajrore portugeze, merr për herë të katërt, rolin udhëheqës të misionit Baltik të Policisë Ajrore. Gjatë ceremonisë tradicionale në Šiauliai Airbase më 2 maj, detashmentit të Forcave Ajrore të Portugalisë iu dha çelësi simbolik i hapësirës ajrore Baltike nga detashmenti i Forcave Ajrore Mbretërore Daneze. Një detashment shtesë i Forcave Ajrore Spanjolle, që gjithashtu është i vendosur në Šiauliai, ju shtohet avionëve portugezë gjatë rotacionit të tyre, pranë një detashmenti francez që vepron në Ämari, Estoni, që nga 3 maji, sipas burimeve të NATO-s.

"Si komandant portugez i F-16, unë jam krenar që jam pjesë e kësaj përpjekjeje të bashkuar, të vetëdijshëm për përgjegjësinë e madhe dhe 100% të përkushtuar ndaj këtij misioni", tha nënkoloneli Afonso Gaiolas, komandanti i detashmentit kryesor portugez, në fjalimin e tij gjatë ceremonisë. Shkëputja e tij përbëhet nga katër avionë luftarakë F-16 dhe një personel prej 84 personash. Komandanti i detashmentit danez që u largua, nënkoloneli Xhon Kristensen, falënderoi ushtrinë

lituaneze për mbështetjen e tyre. "Forcat Ajrore të Lituaniës dhe gjithë personeli i Airbase-it na dhanë përkrahje të jashtëzakonshme", tha ai. Duke iu drejtuar Airmen-it, ai shtoi: "Ne kemi zgjidhur misionin me avionë gati 100% në kohë, me vetëm 54 vetë. Kjo mund të bëhet vetëm me personel të përkushtuar dhe të trajnuar mirë". Pilotët danezë kryen një fluturim gjatë paradites në kryeqytetin e Lituaniës Vilnius duke shënuar kështu dhe mbylljen e rrotacionit danez të kontributit të tyre që përkoi dhe me ditën e 100 vjetorit të pavarësisë së Lituaniës. Ndër të ftuarit e ceremonisë së dorëzimit dhe marrjes së detyrës ishte gjenerali Tod Wolters, Komandanti i Komandës Ajrore Aleate. Duke ju drejtuar të tre detashmenteve, ai tha: "Unë do të doja të shpreh mirënjohjen time personale dhe profesionale për ju, pilotët, mirëmbajtësit, mbështetësit e misionit dhe operatorët për atë që keni bërë dhe do të vazhdoni të bëni për të siguruar qiellin e NATO-s."



Komanda Ajrore e Aleancës, me seli në Ramstein, Gjermani është komanda e vetme e NATO-s për të gjitha çështjet ajrore të Aleancës dhe mbikëqyr të gjithë policimin ajror në hapësirën ajrore evropiane të NATO-s. Të dyja forcat ajrore nga Portugalia dhe Spanja nuk janë të reja për misionin. Gjatë historisë katërmëdhjetëvjeçare të Policisë Ajrore të Baltikut, forca ajrore portugeze u dërgua në Lituani tri herë në vitin 2007, 2016 dhe 2014. Forcat Ajrore Spanjolle po kontribuojnë për misionin për të pestën herë pas dy dislokimeve në Šiauliai në 2006 dhe pas shtimit të misionit dy herë në Ämari, Estoni në 2015 dhe 2017. Katër avionë spanjollë të Eurofighter Typhoon do t'i shtohen F-16 të Portugalisë gjatë rotacionit aktual. Një detashment i tretë i Forcave Ajrore Franceze do të marrë një rol shtesë për Forcat Ajrore Italiane më 3 maj në Ämari të Estonisë.

NATO - Irak: Forcim i qeverisjes në strukturat e sigurisë

Mbi njëqind përfaqësues nga njëzet ministri dhe institucione në të gjithë qeverinë e Irakut morën pjesë në një workshop të organizuar nga NATO në Bagdad, më 24-26 prill 2018. Theksi u përqendrua në praktikën më të mirë për të forcuar transparencën, llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë brenda institucioneve të sigurisë kombëtare dhe institucioneve të tjera qeveritare, thonë burimet e NATO-s. Gjeneral brigade Francesco Giuliano, zyrtari i lartë ushtarak i NATO-s në Irak, nënvizoi ndikimin e korrupsionit në sigurinë e qëndrueshme. "Efektet e korrupsionit janë shkatërruese për shtetin, pasi ato shkaktojnë dështimin e sistemeve të mbrojtjes", vuri në dukje ai. Institucionet e mbrojtjes transparente dhe të përgjegjshme janë çelësi për stabilitetin e shteteve. Në përputhje me Politikën e NATO-s të Ndërtimit të Integritetit, të miratuar nga Krerët




e Shteteve dhe Qeverive në Samitin e NATO-s në Varshavë në 2016, Aleanca u ofron mbështetje anëtarëve të saj dhe vendeve partnere për të forcuar qeverisjen e mirë dhe integritetin në strukturat e tyre kombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë. Seminari ofroi një forum për përfaqësuesit irakianë për të shkëmbyer pikëpamje, duke përfshirë edhe me partnerët ndërkombëtarë, se si të trajtojnë çështjet e korrupsionit brenda organizatave të tyre përkatëse. Pas dis-

fatës ushtarake të Daesh, qeveria e Irakut e ka bërë luftën kundër korrupsionit përpjekje të saj kryesore. Procesi i luftimit të korrupsionit është kompleks. Duke cituar kryeministrin irakian, gjeneralbrigade Riad tha se "lufta kundër korrupsionit në vendin tonë është më e rrezikshme se lufta kundër terrorizmit". Në këtë sfond, seminari i përmendur paraqiti pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë, ndër të tjera, Kombet e Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Kjo iniciativë ishte pjesë e një serie workshop-esh të organizuara nga NATO për të rritur bashkëpunimin midis institucioneve civile dhe ushtarake të Irakut. Këto ngjarje kontribuojnë në trajnimin më të gjerë të NATO-s dhe përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve që synojnë përmirësimin e efektivitetit dhe qëndrueshmërinë e strukturave të sigurisë irakene.

Stoltenberg "promovoi" Sallën Nr.1 të Aleancës

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg hapi të mërkurën më 9 maj sallën 1 të re të Aleancës me takimin e parë të Këshillit të Atlantikut të Veriut në selinë e re të Aleancës. E ngjashme me një auditor dhe e pajisur me teknologjinë më të fundit audio-vizuale, Salla 1 është vendi ku ambasadorët mbajnë debatet më të rëndësishme të Aleancës dhe marrin vendimet më të rëndësishme. Takimi i 29 ambasadorëve të vendeve aleate, autoritetit më i lartë vendimmarrës i NATO-s, u mbajt ndërsa Staf i Aleancës dhe përfaqësuesit kombëtarë të 29 vendeve aleate vazhdojnë të zhvendosen në kompleksin e ri. Rreth gjysma e tyre, nga 4000 personel që punojnë në NATO, tani kanë hyrë në kompleksin e ri. Zhvendosja do të përfundojë në mes të qershorit dhe përpara takimit të korrikut të Aleancës në Bruksel.



Për herë të parë pjesë e këtij ushtrimi, me njësitë dhe përfaqësuesit e tyre, janë edhe shtetet si: Shqipëria, Garda e Ajovës dhe Ushtria Amerikane për Evropë (SHBA), Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe KFOR-i përfaqësuesit e Agjencive të Sigurisë dhe Emergjencave të Kosovës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe Kryqi i Kuq i Kosovës.



Berisha dhe Rama në vendkomandën e stërvitjes

FSK zhvillon stërvitjen ndërkombëtare "Shqiponja 6"

Morën pjesë forca nga Shqipëria, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, KFOR-I, Garda e Ajovës dhe Ushtria Amerikane për Evropë (SHBA), përfaqësuesit e Agjencive të Sigurisë dhe Emergjencave të Kosovës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe Kryqi i Kuq i Kosovës

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Rrustem Berisha së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK-së), gjenerallejtënant Rrahman Rama vizituan vendkomandën e stërvitjes fushore ndërkombëtare, në fshatin Koliq të Prishtinës, ku ishin të dislokuar pjesëtarët e FSK-së së bashku me pjesëtarët e ushtrive partnere për të realizuar stërvitjes fushore „Shqiponja 6“, të parin me karakter ndërkombëtar.

Në Komandën e Përparme Operacionale, të vendosur në fshatin Koliq, ku ishin të përfaqësuara të gjitha njësitë e stërvitjes fushore ndërkombëtare „Shqiponja 6“, komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë (BRSH), gjeneral brigade Fadil Hadergjonaj njoftoi për audiencën kryesore të stërvitjes dhe njësitë pjesëmarrëse.

Gjatë vizitës, ministri Berisha dhe gjeneral Rama, u njoftuan nga drejtori i stërvitjes fushore, gjeneral brigade Naim Haziri, me qëllimin, objektivat, skenarin e stërvitjes fushore dhe me aktivitetet që u zhvilluan së bashku me ushtritë e vendeve partnere, Policinë e Kosovës, Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave si dhe Kryqin e Kuq të Kosovës.

Ndërkaq, komandanti në detyrë i ushtrimit, nënkolonel Sylejman Cakaj, para ministrit dhe komandantit të FSK-së paraqiti një ekspozitë të aktiviteteve dhe operacioneve të zhvilluara që nga dita e dislokimit e deri më sot, si dhe i njoftoi ata me bashkërendimin e veprimeve dhe ndërveprueshmërinë e FSK-së me institucionet vendore dhe partnerët gjatë këtyre ditëve që po zhvillohet ushtrimi.

Me këtë rast, ministri i FSK-së, z. Rrustem Berisha përgëzoi stafin planifikues dhe menaxhues të stërvitjes duke shprehur besimin e plotë se skenari i stërvitjes do të realizohet në tërësi dhe se ushtrimi do t'i arrijë objektivat e veta trajnuese. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama e vlerësoi si mjaft të rëndësishme pjesëmarrjen e ushtrive partnere në ushtrim, atë të KFOR-it si dhe agjencive vendore, duke theksuar se është me rëndësi komunikimi dhe ndërveprueshmëria ndërmjet institucioneve, në mënyrë që ushtrimi ndërkombëtar të arrijë objektivat e veta, ashtu siç është planifikuar. Në Komandën e Përparme Operacionale, qëndruan sot edhe gjeneralë e oficerë të lartë të FSK-së, të vendeve partnere, atashë të akredituar si dhe zyrtarë të lartë të Presidencës dhe agjencive të sigurisë.

Për herë të parë pjesë e këtij ushtrimi, me njësitë dhe përfaqësuesit e tyre, janë edhe shtetet si: Shqipëria, Garda e Ajovës dhe Ushtria Amerikane për Evropë (SHBA), Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe KFOR-i përfaqësuesit e Agjencive të Sigurisë dhe Emergjencave të Kosovës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) dhe Kryqi i Kuq i Kosovës.

Në ditën e parë të stërvitjes më 4 maj, përfaqësuesi i vendeve partnere pjesëmarrëse në këtë ushtrim koloneli Justin Wagner nga Ajova-SHBA tha se “ky vit është vit historik dhe i veçantë për këtë ushtrim dhe është hera e parë që Forca e Sigurisë së Kosovës është mikpritëse e një ushtrimi fushor të kësaj



përmase së bashku me ekipet e specializuara ushtarake të 8 shteteve partnere. Ne kemi detyrë aktive si Gardë Nacionale të përfaqësojmë partnerët ndërkombëtarë gjatë këtij ushtrimi. Ata do të shërbejnë në detyrën e Policisë Ushtarake, personelit mjekësor, inxhinierisë, ekipit të bashkëpunimit civilo-ushtarak, njësitë motoristike, çështjeve publike e po ashtu edhe vëzhgues/kontrollues dhe vlerësues të ushtrimit. Kjo vërtetë është një mundësi e veçantë trajnimi

për këtë grup nga grupi ndërkombëtar, për të punuar së bashku me partnerët tanë të FSK-së dhe po ashtu edhe me pjesëmarrësit tjerë nga agjencitë institucionale të Kosovës.”

Stërvitja fushore e FSK-së “Shqiponja 6” përveç ushtrimeve të parapara në fshatin Koliq, i vazhduar aktivitetet edhe në Prishtinë, Obiliq, Podujevë, Novobërdë dhe Gjilan. Ushtrimi fushor „Shqiponja 6” ka filluar më 4 maj dhe ka përfunduar më 11 maj 2018.

STËRVITJA “COMBINED RESOLVE X”

Pjestarë të FSK-së gjatë stërvitjes në Gjermani

Komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Enver Cikaqi vizitoi nga afër operacionet e ushtrimit “Combined Resolve X”, ku po marrin pjesë edhe 15 pjesëtarë të FSK-së, në Ditën e Vizitorëve të Shquar, krahas personaliteteve tjera ndërkombëtare, në Gjermani.

Gjenerali Cikaqi, nga drejtuesit e ushtrimit, mori komente dhe vlerësime shumë të larta për angazhimin, disiplinën dhe profesionalizmin që po tregojnë pjesëtarët e FSK-së, të cilët gjatë zhvillimit të këtij ushtrimi kanë pasur mundësi të punojnë dhe operojnë krah për krah me kolegët e tyre nga ushtritë ndërkombëtare, duke përfituar nga shkëmbimi i përvojave se si duhet punuar dhe vepruar në një mjedis shumëkombësh.

Gjatë kësaj vizite, komandanti i Forcave Tokësore pati takime të shumta me përfaqësues të ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s, me të cilët diskutoi për krijimin e mundësive rreth shkëmbimit të përvojave në kuadër të bashkëpunimit dypalësh rajonal. Ushtrimi “Combined Resolve X” po realizohet nga Ushtria Amerikane për Evropë (USAREUR) në Bazën e Ushtrisë Amerikane në Grafenlöhren të Gjermanisë. FSK në këtë ushtrim po merr pjesë me një kontingjent prej 15 pjesëtarësh. Fokusi dhe objektivi i këtij ushtrimi është ndërveprimi operacional i të gjithë pjesëmarrësve nga ushtria e NATO-s dhe aleatë tjerë, për të kuptuar dhe krijuar procedura operuese të përbashkëta. Ky është ushtrim shumëkombësh i operacioneve të unifikuara tokësore (Multi Unified Land Operation), i drejtuar nga Shtabi i Departamentit të Ushtrisë së SHBA-së, për të stërvitur forcën e caktuar rajonale të SHBA-së, të nivelit të brigadës, në mbështetje të objektivave të Komandës Evropiane të SHBA-së (EUCOM), për bashkëpunim dhe siguri, ndërtimin e gatishmërisë me aleatët dhe partnerët e NATO-së.


RAYMOND THÉBERGE

FSK-ja tani ka filluar të ketë mbështetje edhe në veri

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha i shoqëruar nga komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka pritur sot z. Raymond Théberge komisionar për gjuhët zyrtare në Kanada, i cili shoqërohej nga ambasadori i Kanadasë për Kroaci dhe Kosovë z. Daniel Maksymiuk. Ministri Berisha e ka njoftuar komisionarin Théberge me zhvillimet dhe aktivitetet në FSK, kapacitetet operacionale, përfaqësimin e komuniteteve pakicë nga tërë territori i Kosovës, prezencën e gjinisë femërore, përdorimin e gjuhëve zyrtare si dhe faktin se FSK-ja është institucioni më i besuar nga qytetarët e vendit. Ai vuri theksin në integrimin e komuniteti serb në radhët e FSK-së përfshirë ata nga pjesa veriore. FSK-ja, tha ministri, tashmë ka kaluar shifrën 10% të pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë. Ai po ashtu foli edhe për përfaqësimin e gjinisë femërore në FSK, i cili vlerësohet i mirë dhe me tendencë rritjeje, duke theksuar se tash FSK-ja për herë të parë ka një femër me gradë gjenerali. Po ashtu ministri ka folur edhe për bashkëpunimin e mirë që ekziston me shtetet fqinje të rajonit, NATO-n, Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NALT-in) dhe KFOR-in; ushtrimet e përbashkëta, trajnimet dhe shkollimet e kadetëve të FSK-së jashtë vendit si dhe pjesëmarrjen aktive të FSK-së në ushtrimet fushore jashtë vendit së bashku me shtetet partnere.

Duke u bazuar në vullnetin e dyanshëm për bashkëpunim, ministri Berisha ka parashtruar fushat me interes për bashkëpunim në mes të dy ministrive përkatëse, MFSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Kanadasë. Përveç fushave ekzistuese ky bashkëpunim të jetë më shumë i përqendruar në fushën e trajnimeve, çështjes së komuniteteve dhe në mbështetjen për integritet në organizata të sigurisë dhe në misionet paqeruajtëse aty ku FSK-ja ka kapacitete të dëshmuara. Nga ana e tij z. Raymond Théberge, komisionar për gjuhët zyrtare në Kanada, shprehu përgëzimet për arritjet e FSK-së në fushën e integriteteve të komuniteteve pakicë veçanërisht për faktin se FSK-ja tash ka filluar të ketë mbështetje edhe në veri. Ai vlerësoi lart faktin se FSK-ja përfaqëson dhe reflekton shkallën e diversitetit të komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Ai shprehu bindjen se modeli kanadez do të jetë i dobishëm edhe për realitetin e Kosovës, duke shprehur edhe gatishmërinë personale për të kontribuar në këtë drejtim. Ai po ashtu vlerësoi lart edhe shkallën e bashkëpunimit të deritashëm në mes të Ministrisë së Mbrojtjes së Kanadasë dhe MFSK-së. Të pranishëm në takim ishin edhe shefi i Kabinetit të Ministrit z. Jashar Ramadani, gjeneral brigade Irfete Spahiu, komandante e KDS-së dhe Sinan Geci, shefi i Sektorit për Integritet Euro Atlantike. Kurse nga delegacioni kanadez ishin kolonellët nga Forcat e Armatosura të Kanadasë z. Anthony Thys dhe z. Pierre Ouellet.





Matisse: Ne vlerësojmë përpjekjet tuaja. Ato pohojnë vendimin e NATO-s në Bukuresht në vitin 2008 që Maqedonia të marrë ftesën e anëtarësimit „sapo të arrihet një zgjidhje e pranueshme reciprokisht për çështjen e emrit” me Greqinë. Ne mirëpresim punën tuaj me Greqinë për të zgjidhur këtë çështje dhe shpresoj që së shpejti do të ketë rezultate. Ne nuk duam të shohim të ndaleni në dyert e NATO-s.



SHEKERINSKA NË SHBA

Maqedonia dhe SHBA kanë një partneritet të fortë strategjik. SHBA vlerësojnë hapat që Maqedonia i merr drejt NATO-s dhe nuk duan ta shohin Maqedoninë të ndalur në dyert e Aleancës-u tha në takimin zyrtar të ministres së mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, Radmilla Shekerinska, me Sekretarin e Mbrojtjes të SHBA, James Matisse në Pentagon, në takimin e zhvilluar në 1 maj 2018. Sekretari amerikan i mbrojtjes James Matisse në fillim të takimit kujtoi fjalët e ministres Shekerinska në takimin e ministrave të mbrojtjes të NATO-s mbi sfidat me të cilat ballafaqohet Perëndimi.

„Ju ishit bindëse dhe fjalët tuaja dominuan në diskutim, duke na kujtuar fuqishëm përgjegjësinë tonë për të mbrojtur vlerat demokratike“, tha Matisse. Ai tha se SHBA vlerësojnë angazhimet që Maqedonia merr si partner i NATO-s-dërgimin e trupave në misionin “Mbështetje e Vendosur” në Afganistan, kontributin në koalicionin për mundjen e ISIS dhe vendimin e rëndësishëm për ndarjen e 2% të PBV-së për mbrojtje.

„Ne vlerësojmë përpjekjet tuaja. Ato pohojnë vendimin e NATO-s në Bukuresht në vitin 2008 që Maqedonia të marrë ftesën e anëtarësimit „sapo të arrihet një zgjidhje e pranueshme reciprokisht për çështjen e emrit” me Greqinë. Ne mirëpresim punën tuaj me Greqinë për të zgjidhur këtë çështje dhe shpresoj që së shpejti do të ketë rezultate. Ne nuk duam të shohim të ndaleni në dyert e NATO-s. Situata e sotme e sigurisë kërkon një frymë miqësie midis të gjithë atyre që avokojnë për lirinë, të drejtat themelore të njeriut dhe sundimin e ligjit”, tha Matisse.

Ministrja Shekerinska falënderoi për mbështetjen e fortë që Maqedonia e merr nga SHBA dhe kujtoi konsensusin e fortë në vend që nga pavarësia e saj, për anëtarësim në NATO.

„Më lejoni t’ju siguroj se Maqedonia është gati për anëtarësim në NATO. Shpejt u rimëkëmbëm nga kriza e gjatë politike dhe pas një vrulli të fortë reformash shihemi si një burim shprese në Ballkan. Kemi filluar reforma të rëndësishme të mbrojtjes dhe kemi rritur kontributin tonë në misionin e udhëhequr nga NATO në Afganistan. Ne dëshmuam se jemi një partner i përkushtuar dhe i besueshëm. Qëllimi ynë është të jemi një aleat i tillë. Pra, më lejoni të kërkoj mbështetjen tuaj si një partner strategjik i anëtarësimit tonë në NATO. Ftesa e Maqedonisë në korrik do të na mbështesë në qëllimin tonë strategjik, do të ndihmojë rajonin në ndërtimin e stabilitetit afatgjatë dhe për të rritur ndikimin dhe gatishmërinë e SHBA-së dhe NATO-s”, tha ministrja Shekerinska.

Ky është takimi i parë i ministrave të mbrojtjes të Maqedonisë dhe SHBA-së pas 6 vjetësh dhe është realizuar në një periudhë vendimtare, vetëm dy muaj para Samiit të Aleancës në kor-

Matisse: Nuk duam t’ju shohim të ndalur në dyert e NATO-s



rik në Bruksel. Gjatë vizitës Ministrja Shekerinska ka zhvilluar takime ne Shtepine e Bardhë dhe Departamentin e Shtetit ku është takuar me z. William Berkley, drejtor i çështjeve evropiane në Këshillin e Sigurimit Kombëtar të Shtëpisë së Bardhë, ndërsa në Depar-

tamentin e Shtetit me Tina Kaidanow, Ndhimës Sekretare për Çështje Politike dhe Ushtarake. Ajo gjithashtu u takua me nënkryetarin e Institutit Kombëtar Demokratik Sharri Brown dhe Drejtorin Rajonal për Evropën Qendrore dhe Lindore, Robert Benjamin.



Kurorë në Varret Kombëtare Ushtarake "Arlington"

Ministrja Shekerinska e përmbylli vizitën zyrtare në SHBA me vendosjen e kurorës me lule në varin e ushtarit të panjohur në Varret Kombëtare Ushtarake „Arlington”, më 2 maj 2018. Shekerinska gjithashtu vizitoi Qendrën Përkujtimore të Varrezave të Arlingtonit, ku dhuroi një pllakë në nder të ushtarëve të rënë amerikan. Gjatë vizitës zyrtare në SHBA u konfirmua partneriteti strategjik mes Maqedonisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Shekerinska u takua me homologun e tij Matisse, i cili riafirmoi mbështetjen e SHBA-së për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe gjithashtu u zhvilluan takime me zyrtarë të lartë të Shtëpisë së Bardhë, Departamentit të Shtetit, Kongresit dhe Senatit.



Shekerinska-Konferencë shtypi në Vermont

Maqedonia e meriton anëtarësimin në NATO

Ministrja e mbrojtjes Radmilla Shekerinska mbajti një konferencë shtypi për mediat amerikane gjatë vizitës së saj në shtetin federal të Vermontit. Në konferencën për shtyp, Shekerinska iu përgjigj pyetjeve gazetareske në lidhje me takimet me guvernatorin dhe komandantin e Gardës Kombëtare në Vermont, për qëllimin e vizitës zyrtare në SHBA, për mesazhet që ajo mori në takimet me zyrtarët në Uashington dhe rëndësinë e mbështetjes nga partneri strategjik për anëtarësim e Maqedonisë në NATO.

„Qëllimi im është të kërkoj mbështetjen e partnerit strategjik të Maqedonisë, Shtetet e Bashkuara përpara Samiit të NATO-s. Maqedonia e meriton vendin e saj në NATO, kemi punuar shumë. Ne kemi treguar se Maqedonia është një partner i përkushtuar në të cilin anëtarët e Aleancës mund të llogarisin. Ne besojmë se ftesa për Maqedoninë për anëtarësim në NATO do të kontribuojë në stabilitetin tonë, por edhe stabilitetin në rajon dhe do të jetë në interesin e SHBA-së”, tha ministrja.



Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriot Skënderbeut

613 vjet nga lindja e Skënderbeut

Lirinë nuk ua solla unë, ate e gjeta mes jush! Sapo më shkeli këmba truallin tuaj, sapo dëgjua emrin tim, m'u derdhët me vrap të gjithë, me dualët përpara kush e kush më parë, sikur të kishit dëgjuar që u ngritën nga varret etërit, vëllezërit, bijtë tuaj, sikur të kishin zbritur këtu gjithë perënditë...".

Janë këto fjalët e Skënderbeut drejtuar popullit shqiptarë, e sot mbarë shqiptarët kujtojnë 613 vjetorin e lindjes së Heroit tonë Kombëtar. Gjergj Kastrioti- Skënderbeu ka lindur më 6 maj të vitit 1405, në një familje fisnike të Dibrës. I ati ishte Gjon Kastrioti, udhëheqës i qyteteve më të mëdha të asaj kohe, Krujës dhe Mirditës dhe e ëma ishte Vojsava. Ai u mor peng nga Sulltan Murati dhe luftoi për Perandorinë Otomane si gjeneral deri në vitin 1443, vit në të cilin u largua gjatë një beteje, duke u rikthyer në Krujë. Në vitin 1444, ai mblodhi të gjithë princërit shqiptarë në Lidhjen e Lezhës, ku u vendos unanimisht të luftohej për marrjen në zotërim të trojeve shqiptare kundër perandorisë



otomane. Në krye të ushtrisë shqiptare, pas fitores së parë kundër otomanëve në betejën e Torviollit, Skënderbeu do të korrte 22 fitore të mëdha kundër Perandorisë osmane, në vitet e luftës

në krye të ushtrisë së vet, që kishte si kryeqendër Krujën.

Heroi kombëtar do të njihej për luftën e tij të paepur në një vend kyç mes lindjes dhe perëndimit. Ai do të

njihej si besnik i mbretit të Napolit në traktatin e Gaetës, ku mbështeti mbretin Ferdinand të Napolit në luftën civile të viteve 1460-1461. Në vitin 1463 ishte komandant i forcave të kryqëzatës së

Papa Piut II, ndërsa vdiq më 17 janarin e 1468, në moshën 63-vjeçare. Gjergj Kastrioti Skënderbeu konsiderohet nga shumë vende të Europës Perëndimore si heroi që pengoi Perandorinë otomane të pushtonte Perëndimin e Europës.

Skënderbeu mbetet kurora e historisë shqiptare, frymëzimi i shpirtit luftarak dhe shëmbëlltyrë për bashkimin e shqiptarëve. Qeveria shqiptare e ka shpallur vitin 2018 si Vitin Mbarëkombëtar të Skënderbeut, ku po organizohen një sërë aktivitësh artistike dhe kulturore. Në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Muzeu Historik Kombëtar çeli të martën ekspozitën me koleksionin e Patricia Nugee-së, i cili përbëhet nga 37 libra unikë. Pjesa e koleksionit të shek. XVI, paraqet 12 libra të botuar në mes viteve 1510 dhe 1597. Nëntë prej tyre janë botime dhe përkthime të veprës së Marin Barletit. Një numër shumë i madh autorësh, të epokave të ndryshme historike dhe rrymave të ndryshme letrare, i janë përqasur kësaj figure duke krijuar një mori veprash të gjinive dhe lloje të ndryshme letrare.

ALBERT Z. ZHOLI

BOLONJË-VITI 1816

Suedezi Lorenzo Thjulen dhe libri për Skënderbeun

Ky libër i rrallë është botuar për herë të parë në vitin 1816, në Bolonjë të Italisë nga Tipografia Arqipeshkvnore

Për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu janë shkruar shumë vepra, duke filluar që nga librat historikë, opera, poema, etj. Në to pasqyrohet lufta e këtij Gjigandi, në krye të një populli të vogël, për të ruajtur pavarësinë dhe lirinë e vendit tonë. Më i hershmi nga librat për Skënderbeun konsiderohet ai i Tivariotit anonim, i shkruar në vitin 1480, dhe pas tij doli vepra e Barletit, rreth viteve 1508-1510, e cila është shtypur në Romë.

Nga të gjithë librat, përhapje më të madhe mori ai i Barletit. Deri në fund të shekullit XVI historia e Skënderbeut, e përpiluar nga Barleti është botuar katër herë në origjinal dhe u përkthye po në atë shekull në gjuhët gjermanisht, italisht, portugalisht, frengjisht, katalançe, anglisht dhe polonisht.

Në kuadrin e Vitit të Skënderbeut, edhe shtëpia botuese "Villamasi" ka dalë me një libër të ri, të përkthyer më parë në vendin tonë. Ai titullohet Dialog në Mbretërinë e të Vdekurve, i priftit jezuit Lorenzo Ignazio Thjulen. Në këtë vepër autori ka krijuar, mbi bazën e ngjarjeve dhe fakteve reale të ndodhura, një dialog ndërmjet heroit tonë Gjergj Kastrioti dhe perandorit Karli i Madh.

Ky libër është botuar për herë të parë në vitin 1816, në Bolonjë të Italisë nga Tipografia Arqipeshkvnore.

Në fakt, Karli i Madh dhe Skënderbeu siç dihet, kanë jetuar në periudha të ndryshme kohore, por nisur nga bëmat e këtyre dy burrave të mëdhenj, autori i ka "takuar" ata në Mbretërinë e të Vdekurve dhe ka krijuar një Dialog ndërmjet tyre.

Fama e Skënderbeut ishte përhapur shumë si në Perëndim ashtu dhe në Lindje të Europës, për luftën e tij kundër sundimit Osman, prandaj dhe që në fillim, Karli i Madh, kur merr vesh se kush është ky njeri i cili "nga fizionomia, nga pamja luftarake, nga hapi i sigurt dhe hija e madhërishtme,

gjykoi se kishte qenë një luftëtar i madh, i thotë se "... fama juaj ende jehon në Mbretërinë e të Vdekurve ...". Në një dialog ku Karli i Madh pyet për jetën dhe veprën heroin tonë kombëtar, ky i tregon për të gjitha ngjarjet e jetës së tij, duke filluar nga "ëndërra e Vojsavës, kohën kur ishte peng te Sulltanit dhe i shërbeu atij, dyluftimet që kishte bërë atje, betejat të cilat i kishte fituar dhe famën që kishte arritur në oborrin e Sulltanit; i tregon për betejat e zhvilluara në krye të shqiptarëve kundër turqve, ku flet edhe për të vetmen disfate dhe plagën që mori në një betejë, vërejtjet që i bën Karli i Madh etj., i cili në fund i thotë: "Me të drejtë jeni nderuar nga miqtë dhe nga armiqët, dhe njeriu i virtytshëm shpejt ose vonë fiton lavdërimet e të gjithëve".

Po ashtu, në libër tregohet se edhe vetë Karli i Madh i tregon jetën dhe veprat e tij në krye të frankëve, betejat që zhvilloi kundër saksonëve, longobardëve, luftën për konvertimin e tyre në katolikë etj.

Në fakt, gjatë dialogjeve ndërmjet Skënderbeut dhe Karlit të Madh dalin në pah teoritë dhe rrymat e kohës, të vëna në gojën e këtyre dy heronjve nga vetë autori Thjulen. Ky autor ka lindur në 2 nëntor të



vitit 1746 dhe në autobiografitë e përpiluar prej vetë Thjulen del se ka origjinë luteriane, është konvertuar në katolicizëm dhe pastaj është futur në Shoqërinë e

Jezusit, deri në shpërndarjen e tyre në vitin 1773. Sipas shkrimeve të Thjulen, i cili ishte në opozicion me francezët kur këta mbërritën në Itali, ai përpigje të hidhte poshtë të vërtetat revolucionare dhe të zbulonte mashtrimin e fshehtë të "jakobinëve diabolikë". Ky jezuit ishte i bindur dhe mbështeste mendimin se iniciativa për ndryshime rendi dhe qeverije "i takonte vetëm sovranëve të veshur me pushtet drejtpërdrejt nga Zoti", se "aleanca ndërmjet Fronit [mbretëror] dhe Altarit ishte përgjigje më e mirë për të luftuar Revolucionin". Libri është sjellë në gjuhën shqipe nga përkthyesi Vladimir Bregu dhe është i pajisur me shumë shpjegime dhe sqarime për të gjithë personazhet e kohës së të dy heronjve.

Abati Lorenzo Ignazio Thjulen ka lindur në Goteborg të Suedisë më 2 nëntor të vitit 1746. Gjithçka që dimë për jetën e tij është frut i ripunimit kritik të jetës së tij, e shoshitjes nën dritën e konvertimit të tij në fillim në katolicizëm, dhe në futjen në Shoqërinë e Jezusit. Kanë qenë pesë autobiografitë që shkroi (1770, 1778, 1831 dhe dy

versione në vitin 1833), secila e nxjerrë duke e përshtatur kujtesën me kohën përkatëse dhe e censuruar nga aspektet gjithnjë aktuale. Shqetësimi se kishte origjinë luteriane gjeti hapësirë shumë të madhe në përpilimin e parë të çiltër, dhe e kufizuar në të tjerat, duke harruar funksionin salvifik të nënës, paraqitet si protagonist i vetëm i konvertimit të tij. I njëjtë ishte fati i etërve jezuitë që u shqëruan në Itali në kohën e dëbimit të tyre nga Spanja: përcaktuese në konvertimin e tij të parë, spektatorë të përtëritjes së tij në autobiografitë e përpiluara në periudhën e Restaurimit. Në Bolonjë, ku ishte vendosur pas shpërndarjes së Shoqërisë në 1773, Thjulen vëzhgoi fillimin e Revolucionit francez, radikalizimin e tij, ekzekutimin e Luigjit XVI, perëndimin e Robespierit, zhvillimet tragjike direktoriale, të gjitha të përshkruara dinakërisht si një degjenerim i tmerrshëm i një njerëzimi që kishte braktisur rrugën e drejtë hyjnore. Me mbërritjen e francezëve në Itali, për shkak të opozicionit të tij u mënjanua, u internua, u dënua me proskripcion; dhe ndërsa Republika rrethohej nga ankesat e jakobinëve të tradhtuar, Thjulen filloi një seri shkrimesh për të hedhur poshtë të vërtetat revolucionare dhe për të zbuluar mashtrimin e fshehtë në fjalët e përdorura nga "jakobinët diabolikë". Në ndryshim nga publicistika më intransigjente, nuk arriti kurrë që të justifikojë kryengritjet, revoltën e çrregullt të shumicës kundër çdo lloj qeverie, i bindur se iniciativa i takonte vetëm sovranëve të veshur me pushtet drejtpërdrejt nga Zoti. Një legjitimist absolut, i bindur se aleanca ndërmjet Fronit dhe Altarit ishte përgjigje më e mirë për të luftuar Revolucionin. Një "satelit i poshtërit i fronit", për saktësi, titulli me të cilin ai vetë stolisej duke marrë hua akuzat e armiqve. Por edhe dëshmitar i papërkulshëm i vonuar për bindjet e tij, në një botë që ndryshonte fyturë përgjithnjë. Vdiq më 5 dhjetor të vitit 1833.



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Shqipëria dhe kontributi i saj në fitore

Në kuadrin e 9 majit, ditës së fitores mbi fashizmin

Mesazhi që dha Shqipëria

Shqipëria, me fillimin e luftës ishte një vend i vogël, si nga përmasat dhe popullsia me afro 1 milionë banorë. Ishte e natyrshme dhe e llogjikshme se ajo nuk mund të vendoste fatet e luftës gjigande e shkatërrimtare. Por, mesazhi që dha Shqipëria në ditën dhe në vitet e para të pushtimit, ishte lufta pa kompromis me pushtuesit nazifashistë. Në këtë mënyrë populli shqiptar, po e rendiste veten në krah të forcave antifashiste botërore. Kjo nuk ishte e lehtë dhe nuk erdhi vetvetiu e njëherazi. Ajo ishte produkt, nga njera anë i zgjerimit dhe i zhvillimit gradual, gjithnjë në rritje i qëndresës e luftës së armatosur të popullit shqiptar dhe, nga ana tjetër, rezultat i një sërë aktesh politike të organeve të larta drejtuese të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Në pikëpamje të forcës ushtarake Shqipëria, nuk trashëgoi asgjë nga ish ushtria mbretërore. Frontit Nacionalçlirimtar dhe Partisë Komuniste shqiptare që mbeti e vetmja forcë politike aktive në luftën kundër fashizmit, ju desh që gjithçka ta fillonin nga elementet më fillestar të organizimit e të veprimit ushtarak. U organizuan njësitet guerrile, si elemente fillestare e më pas, nga fillimi i vitit 1942, u kalua në formimin e çetave atdhetare e partizane, të cilat kryen një sërë goditjesh dhe çliruan zona të tëra në gjithë Shqipërinë, që shërbenin edhe si baza të tyre. Populli shqiptar, duke parë te Fronti Nacionalçlirimtar forcën e vetme që siguronte jo vetëm bashkimin në luftë por edhe zhvillimin zgjerim të saj, u rreshtua gjerësisht nëpër formacionet partizane. Kështu më 10 Korrik të vitit 1943 u krijua Shtabi i Përgjithshëm, ditë që u quajt edhe dita e themelimit të UNÇSH. Gradualisht u kalua nga çetat në batalione, brigada e në gjysmën e dytë të vitit 1944 edhe në divizione e korparmata.

Nga shtrirja, pjesëmarrja e forcave dhe e mjeteve luftarake, dëmet në njerëz, në mjete e të mira materiale, Lufta e Dytë Botërore ishte më e madhja dhe më shkatërrimtarja në historinë e njerëzimit. Fillimi i Luftës së Dytë Botërore më 1 shtator të vitit 1939, Shqipëria, pavarësisht se bota në atë kohë thuajse e kaloi në heshtje, u bë viktima e parë në Evropë, e pushtuar nga forcat e fashizmit italian në prill të atij viti. Në portet shqiptare Durrës, Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë, kur politika evropiane tkurrej nga pesha e trysnisë nazifashiste, u hodhën pushkët e para dhe u dha sinjali i qëndresës antifashiste mbarëevropiane. Krijimi i çetave të para atdhetare, si e Myslim Pezës, përbën jo thjesht krenari, por dhe ndihmesë në fillimet e qëndresës antifashiste evropiane.

Luftën e tij kundër pushtuesit popullit shqiptar nuk e shikonte të shkëputur nga fati e lufta e popujve të tjerë të robëruar dhe në tërësi të Bllokut të Madh Antifashist Botërore. Viti 1942, veçanërisht gjysma e dytë e tij, shënuan disa ngjarje e akte që e afronin atë gjithmonë e më tepër me Aleatët e Mëdhenj. Akti i parë dhe shumë domethënës, ishte padyshim Rezolucioni i Konferencës së Pezës. Ai përshkohej tej e ndanë nga fryma



e parrullës së bashkimit në luftë të të gjithëve, pa dallim feje, krahine, ideje e seksi. Në të shprehej solemnisht se Shqipëria dhe Lëvizja NÇ qëndronin në krah të Kualicionit të Madh Antifashist. Kjo u pasua me një zgjerim të menjëherëshëm të formacioneve partizane e atdhetare dhe të veprimtarisë luftarake të tyre kundër forcave pushtuese. Në mënyrë të llogjikshme, Konferenca, me mesazhet që përcolli por edhe me rezultatet që po binte në zgjerimin e luftës antifashiste, tërhoqi edhe vëmendjen e Aleatëve të Mëdhenj. Britania e Madhe, BRSS dhe SHBA, më 17 e 18 Dhjetor 1942, pavarësisht ndonjë nuance për ardhmërin e kufijve të pasluftës të shprehura nga anglezët, me deklarata të veçanta mbështetën fuqishëm LNC, duke e njohur atë publikisht si aleat në luftën e përbashkët.

Krijimi dhe zgjerimi i UNÇSH

Një akt tjetër, krahas krijimit e zgjerimit të UNÇSH dhe fuqizimit të luftës së armatosur, për nga vendimet që mori për vijimin e luftës, por edhe tepër domethënës i renditjes së Shqipërisë në krah të Aleatëve të Mëdhenj, ishte edhe mbajtja e Kongresit të Pëmetit më 24 Maj 1944. Punimet e tij u zhvilluan duke mbajtur në sfond, krahas flamurit kombëtar e portreteve të atdhetarëve të shquar rilindas, edhe flamujt e tre Aleatëve të Mëdhenj dhe fotografite e Rusveltit, Stalinit e Çerçillit. Në vendimet e tij theksohej solemnisht: "Populli shqiptar do të vazhdojë luftën krah për krahë me Aleatët e Mëdhenj dhe si pjesëtar i Bllokut Antifashist do të gëzojë të gjithë të drejtat që garantohen prej Kartës së Atlantikut, Konferencës së Moskës dhe Teheranit të firmosur prej udhëheqësve të mëdhenj Rusvelt, Stalin e Çerçill". E njëjta frymë e këmbënguljes në krah të Aleatëve të Mëdhenj u përshkua edhe në dokumentet e aprovuara në Konferencën e Dytë të Këshillit Antifashist, mbajtur në Tetor 1944 në qytetin e Beratit.

Në shkallë ndërkombëtare Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar ishte pjesë përbërëse e luftës botërore antifashiste. Me luftën e vet heroike populli ynë i tregoi botës se Shqipëria e vërtetë nuk ishte ajo që një grusht

tradhtarësh e kishin shpallur "aleate të Boshtit", por ajo që populli kryengritës, me Partinë Komuniste në krye, e kishte vënë veten në radhët e pjesëtarëve më aktivë të popujve dhe shteteve të koalicionit të madh antifashist, një popull çlirimtare prej qindra mijë luftëtarësh, që angazhoi në luftë 15 divizione italiane gjermane dhe u shkaktoi atyre mijëra të vrarë, të plagosur dhe dëme të shumta materiale.

Populli kryengritës shqiptar dërgoi edhe përtej kufijve shtetërorë mjaft luftëtarë të Ushtrisë së tij Nacionalçlirimtare, të cilët luftuan me vetëmohim për çlirimin e popujve të Jugosllavisë

të popullit shqiptar në kuadër të Kualicionit të Madh Botëror Antifashist. Shqipëria mbajtikështu një peshë të rëndë në raport me popullsinë.

Vendosja e lidhjeve me Aleatët

Në funksion të çlirimit të vendit nga pushtuesi dhe kuadrin e kësaj aleance, organet drejtuese të LANÇ-it, duke lënë mënjanë mospajtimet për çështje të ndryshme me shtete fqinj apo edhe ngarkesat ideologjike, për një ideal më të madh, vendosën lidhje me Frontet NÇ të Jugosllavisë e Greqisë. Pranë Shtabit e Komandës sonë të Përgjithshme, në vijim të vlerësimit prej tyre



dhe të vëllezërve shqiptarë të Kosovës.

Shqipëria nxorri rreth 70.000 luftëtarë të përfshirë në 24 brigada, 8 divizione dhe 3 korparmata. Konferenca historike e Bujanit i dha një zhvillim të madh Lëvizjes NÇ edhe në Kosovë ku u krijuan 9 brigada partizane dhe rreth 53.000 luftëtarë. Në luftime e operacione të ndryshme në Shqipëri u vranë 28.000 dëshmorë, krahas rreth 20.000 qytetarëve të masakruar, vrarë e gjymtuar nga pushtuesit fashist e nazist.

Në territorin shqiptar shkeli këmba e më së 700.000 trupave nazifashiste dhe u angazhuan rreth 15 divizione italiane e gjermane duke ju nxjerrë jashtë luftimit rreth 70.000 trupa. UNÇSH plotësoi më së miri misionin që mori mbi vete duke çliruar vendin pa qenë e nevojshme që në truallin e saj të futeshin formacione ushtarake të forcave aleate. Kjo përbën, në pamjen luftarake, ndihmesën e drejtpërdrejtë

të angazhimit tonë të pakompromis në Luftën Antifashiste e në krah të Aleatëve, në vitet 1943-1944 erdhën edhe përfaqësues ushtarakë të komandave ushtarake britanike, sovjetike dhe amerikane, duke dërguar edhe ne, në Shtabin Aleat të Mesdhit, përfaqësinë tonë. Madje, Shqipëria, besnike e angazhimit të saj në luftën e përbashkët, dërgoi edhe formacione të veta luftarake për çlirimin e trojeve shqiptare jashtë kufijve tokësorë si në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi e madje edhe deri në Bosnjën Jugore. Kështu SHP dhe Komanda e Përgjithshme e UNÇSH kreu me nder misionin e vet në luftën çlirimtare antifashiste jo vetëm ndaj popullit të vet por edhe ndaj aleatëve dhe popujve fqinjë.

Pushtuesit italo-gjermanë, u treguan shumë aktiv kundër LANÇ-it. Italia fashiste, me politikën e saj ndaj aneksimit territorial të vendit nën stemën mbretërore italiane, krahas përdorimit

të dhunës ushtarake, punoi aktivisht për fashistizimin e jetës së vendit. Në të kundërt, Gjermania fashiste, me qëllim që të shkëpuste popullin nga lufta, luajti me kartën e "pavarësisë" duke mashtruar jo pak forca e politikanë shqiptarë të traditës. Gjithsesi ato u munduan, edhe nëpërmjet qeverive kuisinge të krijonin "ushtrinë", "milicinë" apo "xhandërmarinë" shqiptare, si forca ndihmëse për ruajtjen e qetësisë në vend. Në funksion të qëllimit ato ndërmorën operacion pas operacioni ushtarak e ndëshkimor në treva të ndryshme të Shqipërisë apo edhe në shkallë vendi për shuarjen e LANÇ-it. Përkjekjet e tyre dështuan që në krye.

Ndihmesa e popullit shqiptar në krah të Aleatëve të Mëdhenj për fitoren mbi fashizmin dhe kostua që ai pagoi për këtë është tepër e ndjeshme. Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Frontit NÇ, me forcë kryesore udhëheqëse politike PKS, radhitjen e tij në krah të Aleatëve të Mëdhenj nuk e pa thjesht si një aderim apo solidarizim e aq më pak për ta patur si një kartë për ta tundur në përfundim të luftës. Në të kundërt, besnik i traditave të të parëve të vetë, ai këtë renditje e shikonte dhe e zbatoi, pa as më të vogël hezitim, si një detyrim e angazhim moral e atdhetar për të renditur në frontin e përbashkët gjithë potencialet morale, njerëzore, materiale e luftarake. Dhe ai, në saj të ndihmesës së çmuar në shkallë ndërkombëtare, arriti me dinjtet të radhis veten në ballin e qëndresës antifashiste e në krah të fitimtarëve. Ky pozicionim i prerë antifashist ishte njëherazi edhe një ndihmesë në ruajtjen e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar të pas luftës, të rrezikuar nga lakmitë e shteteve shovene fqinje.

Brezat janë krenarë për këtë luftë

Është ajo luftë dhe sakrificat mbinjerëzore që bënë brezat e shkuar që na japin sot krenarinë kur dëgjojmë që vendi jonë radhitet ndër të parët dhe përfaqësues të tij edhe dekorohen nga të huajt për merita në këtë luftë. Përulëmi me respekt ndaj gjithë atyre që bënë LANÇ-in dhe brezave që përballuan dhe dinjtet peshën e rëndë të saj. Është meritë e padiskutueshme e atyre organeve e personaliteteve politike e ushtarake që udhëhoqën LANÇ-in, të cilët ditën të vendosin e të ruajn raporte të drejta në mes të faktorit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar në këtë luftë për jetë e vdekje. Agjencia Rojter më 1 Nëntor 1940 deklaronte se "...mobilizimi i Shqipërisë dështoi krejtësisht". Dhe kjo nuk erdhi rastësisht apo sikurse vepronin forca të caktuara politike që qëndronin në heshtje apo edhe duke e përkrahur intensivisht pushtuesin e duke ju kundërvënë LANÇ-it. Ishtë një veprimtarë e tërë e atdhetarëve, komunistëve, fetarëve, rinisë, gruas shqiptare që edhe pse nën terrorin fashist, ditën të organizohen dhe të bëjnë të dështojë çdo përkjekje e tyre por edhe e bashkëpunëtorëve dhe shërbëtorëve besnikë për të kthyer fletën e luftës.

5 MAJ

Nderohen Dëshmorët e Aviacionit Ushtarak

Në nderim të jetës, veprës dhe sakrificës së pilotëve dhe teknikëve të Aviacionit Ushtarak Shqiptar zhvilloi homazhe në varrezat e "Dëshmorëve të Atdheut" ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Flamur Hadushi, komandanti i Bazës Ajrore Farkë kolonel Kuto Hasani, ushtarakë të Forcës Ajrore, veteranë të Aviacionit si dhe familjarë të dëshmorëve, Ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, bënë homazhe dhe vendosën buqeta me lule në nderim të dy dëshmorëve të Atdheut pilotëve Floran Delia dhe Donald Hoxha të rënë në krye të detyrës. Gjithashtu në nderim të jetës, veprës dhe sakrificës së pilotëve dhe teknikëve të Aviacionit u vendosën karafila dhe kurora me lule nga Komanda e Forcës Ajrore, shoqata "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit dhe Shoqata e Aviatorëve të Shqipërisë". Çdo 5 maj personeli i Forcës Ajrore përulet me respekt dhe mirënjohje para "Dëshmorëve të Aviacionit", të cilët me përkushtimin dhe vetëmohimin e tyre janë burim frymëzimi për brezat që do të vijnë.

